

# LIGJ PËR MENAXHIM ME PAKETIMIN DHE HEDHURINAT NGA PAKETIMI

TEKST I KONSOLIDUAR [1]

**Teksti në  
gjuhën**

**Maqedonase**

 Закон за  
управување со  
пакување и отпад  
од пакување

## I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

#### Lënda e rregullimit

Me këtë ligj rregullohen kërkesat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, të cilat doemos duhet t'i plotësojë paketimi gjatë prodhimit të tij, lëshimi në treg dhe lëshimi në përdorim, dhe veprimi me hedhurinat nga paketimi që i përfshin obligimet dhe përgjegjësitë e operatorëve ekonomikë dhe të subjekteve tjera të cilët marrin pjesë në procesin e prodhimit, lëshimi në treg dhe lëshimi në përdorim i paketimit, rregullat e grumbullimit, ripërdorimit, ripërpunimit dhe mënjanimit, si dhe kushtet tjera për veprim me hedhurinat nga paketimi; njoftimi dhe instrumentet ekonomike për arritjen e qëllimeve nacionale për grumbullimin dhe përpunimin e hedhurinave nga paketimi.

### Neni 2

#### Zbatimi subsidiar i ligjeve tjera

(1) Për çështjet të cilat janë të lidhura me rregullat për menaxhim me hedhurina nga paketimet, të cilat nuk janë të rregulluara në mënyrë të veçantë me këtë ligj, do të zbatohen dispozitat e Ligjit për menaxhim me hedhurinat.

(2) Për rregullimin e çështjeve lidhur me: qasjen te informatat që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, pjesëmarrjen e publikut në miratimin vendimeve, vlerësimin e ndikimit të strategjive të caktuara, planeve dhe programeve mbi mjedisin jetësor, vlerësimin e ndikimeve të projekteve të caktuara mbi mjedisin jetësor, zbatohen dispozitat e Ligjit për mjedisin jetësor, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(3) Në procedurat e përcaktuara me këtë ligj, zbatohet Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

### Neni 3

#### Qëllimi i ligjit

Në pajtim me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, qëllimet e këtij ligji janë:

- të pengohet krijimi i hedhurinave nga paketimi,
- të zvogëlohet sasia e hedhurinave nga paketimi,
- të zvogëlohet dhe të kufizohet përdorimi i metaleve dhe materieve të dëmshme në paketim, dhe me këtë ta zvogëlojë ndikimin helmues të

**Teksti në  
gjuhën Angleze**

 Law on  
Management of  
Packaging and  
Packaging Waste

hedhurinës nga paketimi,

- të pengohet ose të zvogëlohet ndikimi negativ mbi mjedisin jetësor i hedhurinave nga paketimi dhe të sigurohet shkallë e lartë e mbrojtjes së mjedisit jetësor,
- të arrihet nivel i lartë i ripërdorimit të paketimit;
- të arrihet nivel i lartë i riciklimit dhe llojeve tjera të përpunimit të hedhurinave nga paketimi dhe zvogëlimi i mënjanimit të skajshëm të hedhurinave nga paketimi;
- të sigurohen kushte për vendosjen e sistemeve për kthimin, seleksionimin, grumbullimin, ripërdorimin, përpunimin dhe riciklimin e hedhurinave nga paketimi;
- të sigurohen kushte për vendosjen dhe zhvillimin e tregut të përpunimit dhe riciklimit të hedhurinave nga paketimi dhe
- të sigurohet pozitë e barabartë në treg ndërmjet personave të vendit dhe të huaj juridikë dhe fizikë, dhe të shmangen dhe mënjanohen barrierat tregtare të cilat mund ta çrregullojnë tregun.

## Neni 4

### Zbatimi i ligjit

(1) Dispozitat e këtij ligji zbatohen në të gjitha paketimet që prodhohen dhe lëshohen në treg në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe për të gjitha hedhurinat e paketimit, i cili është kriuar nga kryerja e veprimtarisë prodhuese, industriale, zejtare, tregtare, shërbysese, administrative dhe veprimtaria tjeter, për hedhurinat nga paketimi i cili është kriuar në amvisëri dhe/ose vende tjera në territorin e Republikës së Maqedonisë, pa marrë parasysh origjinën, përdorimin dhe llojin e materialit të paketimit dhe të hedhurinave nga paketimi.

(2) Dispozitat e këtij ligji nuk e përjashtojnë zbatimin e dispozitave të cilat e rregullojnë kualitetin e paketimit, sigurinë, higjienën dhe mbrojtjen sanitare, mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së prodhimeve të paketuara, si dhe rregullat që janë të lidhura me transportin e prodhimeve dhe veprimin me hedhurina dhe hedhurina nga paketimet.

(3) Të gjitha masat, standarde dhe qëllimet të cilat janë të përcaktuara me këtë ligj, zbatohen si kërkesa minimale të cilat duhen të plotësohen gjatë menaxhimit me paketimin dhe hedhurinat nga paketimi.

(4) Nëse me ligj tjetër janë përcaktuar masa dhe standarde të mjedisit jetësor, gjatë menaxhimit me paketim dhe hedhurinat nga paketimi, zbatohen masa më të rrepta dhe standarde me qëllim të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe arritjes së qëllimeve të mjedisit jetësor.

## Neni 5

### Definizione

Shprehje të veçanta të përdorura në këtë ligj, e kanë kuptimin si vijon:

1. Paketim, janë të gjitha prodhimet e bëra nga cilido lloj materiali që shfrytëzohen për ruajtjen, mbrojtjen, manipulimin, dërgimin dhe prezantimin e mallrave, nga prodhuesi deri te shfrytëzuesi ose konsumuesi, pa marrë parasysh atë se a janë mallrat lëndë e parë ose prodhim i gatshëm. Sendet "e pakthyeshme" që shfrytëzohen për qëllimet e njëjta, gjithashtu do të llogariten si paketim, duke përfshirë edhe mjetet ndihmëse të cilat shërbejnë për mbështjelljen, lidhjen dhe/ose përdorimin e mallrave, shënimin e mallrave, përgatitjen për dërgimin ose mbylljen e mallit. Paketimi mund të jetë:

a) paketimi për shitje ose primar (paketim për shitje), është paketim i bërë në atë mënyrë që paraqet njësi të vetme për shfrytëzuesin ose konsumuesin e fundit në vendin e shitjes. Kjo përfshin gota, filxhanë, qese, konserva, shishe, shishe plastike, tuba, kuti, pllaka, gypa etj., ose paketim tjetër i ngjashëm me pjesët përbërëse të cilat e mbështjellin ose

mbajnë njësinë bazë shitëse të mallit të dedikuar për shitje për shfrytëzuesin ose konsumuesin e fundit në vendin e shitjes, dhe e mbrojnë mallin nga dëmtimi ose ndotja. Paketim për shitje janë edhe pjata dhe gota për përdorim të njëhershëm;

b) paketim grupor ose sekondar (paketim grupor) është paketimi i bërë në atë mënyrë që si grup, i mbështjell ose mban së bashku një numër më të madh të njësive themelore shitëse me paketim shitës të llojit të njëjtë ose të ndryshëm të mallit në vendin e blerjes, pa marrë parasysh se a i shiten shfrytëzuesit ose konsumuesit të fundit si grup, ose shiten veç e veç sipas njësisë shitëse ose shërben si mjet për dërgim deri në vendin e shitjes. Paketimi grupor mund të mënjanohet nga njësitet shitëse pa ndikuar në karakteristikat e tij. Kjo përfshin foli, kuti dhe materiale të ngjashme për mbështjellje ose paketim tjeter, pjesët përbërëse të së cilit janë të dedikuara për shpërndarjen, magazinimin, transportin ose dërgimin e mallrave për shitje te shfrytëzuesi ose konsumuesi i fundit. Nëse paketimi grupor njëkohësisht e kryen funksionin e paketimit për shitje, i njëjti llogaritet si paketim për shitje;

v) paketimi për transport ose terciar (paketimi për transport) është paketim i bërë në atë mënyrë, i cili mbështjell ose mban së bashku numër më të madh të njësive themelore shitëse me paketim për shitje ose grupor, me qëllim që ta lehtësojë manipulimin dhe transportin e mallrave dhe ta mbrojë nga dëmtimi gjatë manipulimit dhe transportit. Kjo përfshin fuçi, sëndukë, qypa, thasë, paleta, kuti ose paketim tjeter të ngjashëm. Nëse paketimi për transport njëkohësisht e kryen funksionin e paketimit për shitje, i njëjti llogaritet si paketim për shitje. Kontejnerët, të cilët për transportin e mallrave përdoren në komunikacionin rrugor, hekurudhor, detar ose ajror, nuk janë paketim transporti dhe

g) kur është e nevojshme, përcaktimi për atë se cili send llogaritet për "paketim", do të bëhet edhe përmes zbatimit të këtyre kriterieve:

- sendi do të llogaritet për paketim nëse e plotëson njërin nga definicionet për paketim, të dhënë nën pikën 1 të këtij nenit, pa marrë parasysh funksionet tjera të cilat mund t'i posedojë, me kusht që paketimi të jetë pjesë integrale e prodhimit, dhe është i domosdoshëm për ruajtjen e përbajtjes së tij, e përkrah ose mbron prodhimin gjatë gjithë ciklit të tij jetësor dhe të gjitha elementet e paketimit janë të dedikuara që të përdoren, shpenzohen dhe mënjanohen së bashku me prodhimin,

- sendi i cili është dizajnuar ose dedikuar që të mbushet me përbajtje në vendin e shitjes dhe sendi i dedikuar "për përdorim të njëfishtë" që shitet, mbushet ose është i dizajnuar dhe dedikuar të mbushet në vendin e shitjes, do të llogaritet për paketim nëse e plotëson njëren prej definicioneve për paketim, të dhënë nën pikën 1 të këtij nenit dhe

- pjesët përbërëse të paketimit dhe elementet tjera ndihmëse të vendosura në paketim, llogariten për pjesë të paketimit në të cilën janë vendosura. Elementet ndihmëse që janë varur në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose të vendosura në një prodhim dhe që kryejnë funksion të paketimit, llogariten si paketime, përveç nëse nuk janë pjesë përbërëse e atij prodhimi dhe nëse të gjitha elementet janë të dedikuara të shfrytëzohen ose mënjanohen, së bashku me prodhimin;

2. Hedhuria nga paketimi, janë çdo paketim ose material për paketim, i cili është përfshirë me definicionin për hedhuria, në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhuria, përveç mbeturinave të krijuara gjatë prodhimit të paketimit;

3. Hedhurinat nga paketimi të cilat paraqesin hedhuria komunale, janë hedhurinat nga paketimi shitës dhe grupor, që krijohen si hedhuria të amvisërisë ose hedhuria nga aktivitetet industriale, zejtare, shërbyese ose të tjera, që për nga natyra e vet dhe përbërja e vet, janë të ngjashme me hedhurinat nga amvisëritë;

4. Hedhuria nga paketimi që nuk paraqesin hedhuria komunale, janë hedhuria nga paketimi shitës, grupor ose i transportit, që krijohen si hedhuria gjatë kryerjes së veprimtarisë prodhuese, industriale, zejtare, tregtare, shërbyese, administrative ose veprimtarive tjera dhe sipas natyrës dhe përbërjes së vet janë të ndryshme nga hedhurinat e amvisërisë;

5. Menaxhim me hedhurina nga paketimi, është përbledhje e aktiviteteve, masave dhe vendimeve, të dedikuara për arritjen e qëllimeve nationale për veprim me hedhurinat e paketimit, ndërsa janë ndërmarrë në pajtim me këtë ligj dhe me dispozitat, të cilat e rregullojnë menaxhimin dhe veprimin me hedhurinat;

6. Pengim, është zvogëlimi i sasisë dhe ndikimeve negative mbi mjedisin jetësor, veçanërisht me zhvillimin e prodhimeve dhe teknologjive të "pastra", nga:

- materialet dhe substancat e përbajtura në paketimet dhe në hedhurinat nga paketimi dhe
- paketimi dhe hedhurinat nga paketimi që krijohen gjatë procesit të prodhimitarisë dhe në fazat e lëshimit në treg, lëshimit në përdorim, shpërndarjes dhe mënjanimit;

7. Ripërdorimi i paketimeve, është çdo procedurë me të cilën paketimi është menduar (konceptuar) dhe dizajnuar, në atë mënyrë që gjatë ciklit të tij jetësor, me ndihmën ose pa ndihmën e prodhimeve për paketim, një herë ose më shumë të jetë përsëri i përdorshëm dhe/ose një herë ose më shumë të mbushet për dedikim të njëjtë ose të ngjashëm për të cilin është bërë në fillim. Ky paketim i ripërdorur bëhet hedhurinë nga paketimi, atëherë kur nuk do të jetë më objekt i ripërdorimit ose mbushjes;

8. Përtëritje, është çdo operacion i përpunimit të hedhurinave, i cili mund të zbatohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për menaxhim me hedhurinat;

9. Riciklim i hedhurinave nga paketimi, është çdo përpunim i hedhurinave nga paketimi në procesin prodhues, si lëndë e parë sekondare për prodhimin e paketimeve të reja, të dedikuara për qëllim të njëjtë ose tjetër, duke përfshirë riciklimin organik, e duke e përjashtuar përpunimin energjetik;

10. Përpunim energjetik i hedhurinave nga paketimi, është çdo operacion i përpunimit me të cilin bëhet djegia e hedhurinave së bashku ose pa hedhurina tjera, me qëllim të prodhimit të energjisë dhe shfrytëzimit të energjisë së fituar termike;

11. Riciklim organik i hedhurinave nga paketimi, është përpunim aerob (kompostim) ose anaerob (biometanizim), në kushte të kontrolluara dhe me përdorimin e mikroorganizmove për pjesën e hedhurinave nga paketimi i cili në mënyrë biologjike mund të zbërthehet, me të cilin prodhohet tepricë e stabilizuar organike ose metan. Mënjanimi i hedhurinave nga paketimi në plehërishtë nuk llogaritet për riciklim organik;

12. Mënjanim i hedhurinave nga paketimi, është çdo operacion i cili mund të zbatohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për menaxhim me hedhurinat.

13. Operatorë ekonomikë të lidhur me menaxhimin me paketim, janë:

- prodhues i paketimit, është personi juridik ose fizik i cili prodhon, importon dhe/ose lëshon në treg paketime dhe konvertues të tyre, si veprimtari të veten,
- prodhues, është personi juridik ose fizik i cili paketon mallra ose mbush mallra në paketime, si dhe prodhon, importon dhe/ose lëshon në treg mallra të paketuara në paketime si veprimtari të veten, duke e përfshirë edhe prodhuesin i cili si shfrytëzues i fundit importon mallra të paketuara,
- prodhues i vogël, është personi juridik ose fizik i cili paketon mallra ose mbush mallra në paketime, dhe/ose prodhon, importon dhe/ose lëshon në treg, mallra të paketuara në paketime në sasi në pajtim me nenin 19 të këtij ligji,
- tregtar, është personi juridik ose fizik i cili kryen veprimtari tregtarë dhe furnizon materiale për prodhimin e paketimit, paketime dhe mallra të paketuara për qëllime të shitjes shfrytëzuesit të fundit,
- dërgues i fundit, është personi juridik ose fizik i cili paketimin ose mallin e paketuar, ia dërgon drejtpërsëdrejti shfrytëzuesit, përkatësisht konsumatorit të fundit, pa marrë parasysh nëse njëkohësisht ai person

- është prodhues, paketues ose shitës me pakicë,
- shfrytëzues i fundit, është konsumatori i cili për shkak të përdorimit ose konsumimit të fundit të mallit të paketuar, e ndan mallin dhe/ose e zbraz paketimin dhe në atë mënyrë krijon hedhurina nga paketimi dhe tregtar i cili, për shkak të përdorimit të mëtutjeshëm të mallit, paketimin e ndan nga malli dhe/ose e zbraz paketimin, dhe në atë mënyrë krijon hedhurina nga paketimi grupor ose transportues,
  - personi juridik për veprim me hedhurina të paketimit është person juridik i themeluar nga prodhuesit me qëllim për të përm bushur obligimet nga neni 17 i këtij ligji, i cili ka marrë leje për veprim me hedhurina të paketimit në pajtim me nenin 21 paragrafin (2) të këtij ligji, dhe i cili fitimin e realizuar e shfrytëzon për plotësimin e obligimeve nga neni 17 i këtij ligji dhe
  - veprues i pavarur me hedhurina nga paketimi, (në tekstin e mëtutjeshëm: veprues i pavarur) është personi juridik ose fizik, i cili ka marrë leje për veprim të pavarur me hedhurina nga paketimi, në pajtim me nenin 24 parografi (2) të këtij ligji;

14. Marrëveshje vullnetare, është marrëveshja formale e cila ka klauzola ekzekutive, e lidhur ndërmjet organeve dhe organizatave, të cilat i përfaqësojnë interesat e caktuara të operatorëve ekonomikë, grupeve të operatorëve ekonomikë dhe operatorëve të veçantë ekonomikë nga njëra anë, dhe nga ana tjeter, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, me qëllim që të arrihen qëllimet e këtij ligji të përcaktuara në nenin 3 dhe qëllimet nationale nga neni 35 të këtij ligji, i cili është i hapur për aderimin e të gjithë personave juridikë dhe fizikë, të cilët duan t'i plotësojnë kushtet e përcaktuara me marrëveshje. Marrëveshja vullnetare është e kapshme për publikun, në pajim me ligjin;

15. Paketim kompositë, (kompozitë) është paketimi i përbërë nga më tepër shtresa të materialeve të ndryshme, të cilat me dorë nuk mund të ndahan ose në mënyrë tjetër të ndahan ndërmjet veti;

16. Paketim kthyes, është paketimi për të cilin mund të sigurohet kthimi me paradhënie dhe i njëjtë përsëri mund të përdoret;

17. Kthim i paketimeve, është aktivitet me të cilin sigurohet pranimi kthyes i hedhurinave nga paketimi, i cili nuk e rrezikon shëndetin e njerëzve dhe nuk zbaton procese ose metoda të cilat do të ishin të dëmshme për mjedisin jetësor;

18. Vënie e qëllimshme, është aktiviteti me të cilin me qëllim shfrytëzohet substanca ose materia gjatë formulimit të paketimit ose të komponentëve të paketimit, me ç'rast prania e saj e përhershme në paketimin e fundit ose në komponentin e paketimit, është e nevojshme që të arrihen karakteristika specifike, pamje ose kualitet i paketimit. Përdorimi i materialeve të ricikluara si lëndë të para për prodhimin e materialeve të reja për paketim, ku një pjesë e materialeve të ricikluara mund të përbajnjë sasi të substancave dhe materieve të rregulluara, nuk llogaritet përfutje e qëllimshme;

19. Prani e rastësishme, është prania e metalit si përbërje e vënë pa qëllim në paketim ose pjesë të paketimit dhe

20. Organ për kryerjen e punëve profesionale në sferën e mjedisit jetësor, është Drejtoria e Mjedisit Jetësor, organ në përbërje të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

**21. Person tjetër juridik i pavarur** është personi juridik i regjistruar për kryerjen e shërbimeve profesionale, teknike dhe konsultuese nga sfera e ekonomisë dhe mjedisit jetësor

## Neni 6

### Parime

(1) Në pajtueshmëri me qëllimet për mbrojte afatgjate dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe mbrojte dhe avancim të mediumeve dhe sferave të mjedisit jetësor, menaxhimi me paketimin dhe hedhurinat nga paketimi, bazohen në:

1) parimin e përgjegjësisë së prodhuesit – prodhuesi i cili gjatë kryerjes së veprimitarës së vet, krijon dhe kontribuon në krijimin e hedhurinave nga paketimi, është përgjegjës për ndërmarrjen e masave për menaxhim me paketimin dhe hedhurinat nga paketimi, me qëllim që të eliminohet dhe/ose të zvogëlohet deri në masë të mundshme të fundit, ndikimi negativ mbi mediumet dhe sferat e mjedisit jetësor që ndodh si rezultat i hedhurinave nga paketimi i kriuar nga veprimitaria e tij. Sipas këtij parimi, si prodhues llogaritet edhe prodhuesi i paketimit dhe

2) parimin e vlerësimit të ciklit jetësor të prodhimit - prodhuesi i mallit i cili është i paketuar në paketim dhe si prodhim e lëshon në treg, është i obliguar të bëjë vlerësimin e ciklit jetësor të prodhimit dhe ta dizajnojë në mënyrë me të cilën do të mundësohet ripërdorimi dhe cikli i shtuar jetësor i paketimit dhe prodhimit, zvogëlimi i krijimit të hedhurinave dhe hedhurinave nga paketimi në fund të ciklit jetësor të prodhimit, dhe pengimit të ndikimeve negative mbi mediumet dhe sferat e mjedisit jetësor.

(2) Në menaxhimin me paketimin dhe hedhurinat nga paketimi, përveç parimeve të përcaktuar në këtë nen, në mënyrë përkatëse zbatohen edhe parimet e përcaktuara në Ligjin për mjedisin jetësor dhe në Ligjin për menaxhim me hedhurina.

## II. KËRKESAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR

### **Neni 7**

#### **Masat për pengim dhe parandalim**

(1) Për shkak të pengimit dhe parandalimit në krijimin e sasive të materialeve dhe substancave të rrezikshme të përbajtura në paketim dhe hedhurinat nga paketimi, prodhuesi i paketimit dhe prodhuesi në prodhim ose gjatë importit të materialeve, është i obliguar që të përdorë teknologji dhe procedura prodhuese më të mira, të cilat janë dëshmuar në praktikë dhe të kapshme në treg dhe të cilat, me çmim të arsyeshëm, kontribuojnë në:

- zvogëlimin e krijimit të sasisë së paketimit dhe hedhurinave nga paketimi,
- pengimin dhe zvogëlimin e ndikimeve të dëmshme/negative mbi mediumet dhe sferat e mjedisit jetësor, të shkaktuara për shkak të sasive dhe përbërjes së materialit të paketimit ose hedhurinave nga paketimi dhe
- pengimin dhe zvogëlimin e ndikimeve të dëmshme/negative mbi mediumet dhe sferat e mjedisit jetësor gjatë prodhimit, lëshimit në treg, seleksionimit dhe përdorimit të paketimit, si dhe në përpunimin ose mënjanimin e hedhurinave nga paketimi.

(2) Për realizimin masave nga paragrafi (1) të këtij neni, prodhuesi i paketimit dhe prodhuesi të cilët në nivel vjetor kanë prodhim ose shfrytëzojnë paketim i cili nuk është më i madh se 30 t, janë të obliguar që të përgatisin program për pengimin dhe parandalimin e krijimit të hedhurinave nga paketimi, që veçanërisht duhet të përbajë qëllime kuantitative për pengim dhe parandalim, masa për arritjen e qëllimeve dhe mekanizmave për kontroll të kualitetit të paketimit për shkak të plotësimit të qëllimeve, në pajtim me mundësitë teknike dhe ekonomike.

(3) Programi nga paragrafi (2) i këtij neni, përpilohet për një periudhë prej katër vitesh.

(4) Në rast të ndryshimit të aktiviteteve të subjekteve nga paragrafi (1) i këtij neni, të njëjtit janë të obliguar që të përgatisin program të ri.

(5) Për shkak të përcaktimit më të lehtë të sendeve që do të llogariten për "paketim" në pajtim me kriteret nga neni 5 pika 1, g) të këtij ligji, ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor do ta shpallë listën me shembuj ilustrues për paketim.

## Neni 8

### Lëshimi në treg

Paketimi mund të lëshohet në treg me kusht që t'i plotësojë kërkesat themelore të përcaktuara në këtë ligj, që kanë të bëjnë me prodhimin, përbërjen dhe natyrën e paketimit, dhe për paketimin që përsëri mund të përdoret, duke e përfshirë edhe përshtatshmérinë për përpunim përkatësisht riciklim.

### Neni 8-a

#### **Ndalim për lëshim në treg të qeseve për transport të mallrave**

(1) Ndalohet lëshimi në treg i qeseve për transport të mallrave të prodhuara nga polimeret e etilenit, poli (vinil kloridi) dhe/ose nga masa tjera plastike.

(2) Me përashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, lejohet lëshimi në treg i qeseve bioshpërbërëse të prodhuara në pajtim me standardet e përcaktuara për bioshpërbërje.

(3) Standardet për bioshpërbërje nga paragrafi (2) i këtij neni që duhet t'i plotësojnë qeset për transport të mallrave, mënyrën e lëshimit dhe përdorimit të qeseve bioshpërbërëse për transport të mallrave në treg i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor

## Neni 9

### **Zbatimi i standardeve në menaxhimin me paketim dhe hedhurinat nga paketimi**

(1) Paketimi që prodhohet dhe lëshohet në treg në Republikën e Maqedonisë, duhet të jetë në pajtim me standardet nationale dhe evropiane.

(2) Paketimi i plotëson kërkesat e përcaktuara në standardet nga paragrafi (1) të këtij neni, nëse është prodhuar në pajtim me:

1) standardet e harmonizuara evropiane të miratuar si nationale, e që kanë të bëjnë me:

- kriteret dhe metodologjinë për analizë të ciklit jetësor të paketimit,
- metodat për matjen dhe verifikimin e pranisë së metaleve të rënda dhe materieve dhe substancave tjera të dëmshme në paketim, dhe lëshimin e tyre në mjedisin jetësor nga paketimi dhe hedhurinat nga paketimi,
- kriteret për përmbajtjen minimale të materialit që riciklohet në paketim, për lloje përkatëse të paketimit,
- kriteret për metodat e riciklimit,
- kriteret për metodat e kompostimit dhe për kompostimin e krijuar dhe
- kriteret për shënimin e paketimit dhe

2) standardet tjera nationale nga sfera e kualitetit të paketimit.

## Neni 10

### **Kërkesat lidhur me prodhimin dhe përbërjen e paketimit**

(1) Paketimi përpunohet në atë mënyrë që vëllimi dhe pesha e paketimit,

të jenë të kufizuara në sasinë minimale përkatëse, për mbajtjen e nivelit të duhur të sigurisë, higjienës dhe pranueshmërisë për produktin e paketuar dhe për konsumatorin.

(2) Paketimi duhet të jetë i dizajnuar, prodhuar dhe i shitur në mënyrë që të mundësojë ripërdorimin ose përpunimin, duke përfshirë edhe riciklimin, me ç'rast ndikimi negativ në ambientin jetësor reduktohet në minimum, gjatë mënjanimit të hedhurinave të paketimit ose të mbeturinave të tij, të krijuara gjatë ndërmarrjes së operacioneve për veprim me hedhurinat e paketimit.

(3) Paketimi duhet të jetë i përpunuar në mënyrë që prania e materieve dhe substancave të tjera të dëmshme, prania e metaleve të rënda dhe lëndëve dhe materieve dhe substancave tjera të dëmshme, si përbërës të materialit për paketim ose të cilitdo komponent të paketimit, janë reduktuar në minimum lidhur me praninë e tyre në emisionet, hirin dhe në ekstraktin e lëngët që krijohet gjatë djegies ose mënjanimit të paketimit, ose krijohet gjatë ndërmarrjes së operacioneve për veprim me hedhurinat e paketimit.

## Neni 11

### **Kërkesat për nivelet e koncentrimit të metaleve të rënda të pranishme në paketim**

(1) Niveli i përgjithshëm i koncentrimit të plumbit, kadmiumit, zhivës dhe kromit gjashtëivalent të pranishëm në paketim dhe në materialin ose komponentët e tij përbërëse, nuk guxon të tejkalojë 100 miligram për kilogram të peshës së masës, përvèç për paketimin i cili në tërësi është bërë nga qelqi i kristalizuar i plumbit.

(2) Prodhesi ose prodhuesi i paketimit, me dërgesën e paketimit ose materialet për prodhim të paketimit të cilat i lëshon në treg, është i obliguar që të posedojë të dhëna se janë plotësuar kërkesat nga paragafi (1) i këtij neni.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, përmbajtja e metaleve të rënda mund ta tejkalojë nivelin prej 100 miligramësh për kilogram të peshës së masës për paketime të qelqit, gjabave të plastikës dhe paletave të cilat rrjedhin nga materialet e ricikluara dhe nëse metalet e rënda nuk janë futur qëllimi së procesin prodhues, përkatësisht janë të pranishme rastësisht.

(4) Subjektet nga paragafi (2) i këtij neni si dhe ato paketimi i të cilave përmban metale të rënda nga paragafi (1) i këtij neni, janë të detyruar që të mbajnë evidencë dhe të dorëzojnë raport vjetor për veprim me ato paketime te organi për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor (në tekstin e mëposhtëm: organi profesional).

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, i përcakton mënyrën dhe kushtet për tejkalimin e niveleve të përmbajtjes së metaleve të rënda nga paragafi (3) i këtij neni, si dhe mënyrën e mbajtjes dhe përmbajtjen e evidencës dhe raportit nga paragafi (4) i këtij neni.

(6) Rezultatet e matjeve të kryera në proceset e prodhimit si dhe metodat matëse të shfrytëzuara, duhet të ruhen së paku katër vite dhe të jenë të kapshme në çdo kohë për organet kompetente të inspektimit me kërkesën e tyre.

## Neni 12

### **Kërkesa në aspekt të natyrës së paketimeve të cilat janë të dedikuara për ripërdorim**

Paketimet të cilat janë prodhuar me qëllim që të ripërdoren, duhet t'i plotësojnë këto kërkesa:

- cilësitetë fizike dhe karakteristikat e paketimit duhet të janë të atilla që do të sigurojnë kualitet adekuat të paketimit, me qëllim të ripërdorimit të tij në kushte normale të parapara të shfrytëzimit,
- të mundësojnë që gjatë përpunimit të paketimit të shfrytëzuar që të plotësohen kërkesat lidhur me kushtet shëndetësore dhe të sigurisë përmbrojtje gjatë punës dhe
- të mundësojnë që paketimi i cili nuk mund të ripërdoret mëtej, t'i plotësojë kushtet që duhet t'i plotësojnë hedhurinat e paketimit.

## Neni 13

### Kërkesa në aspekt të përshtatjes së paketimit përpunim dhe riciklim

Paketimi në aspekt të përshtatjes së tij përpunim dhe riciklim të materialit, duhet t'i plotësojë kërkesat në vijim:

- paketimi i cili mund të përpunohet nëpërmjet operacioneve të riciklimit doemos duhet të jetë i përpunuar në atë mënyrë, që kur do të shndërrohet në hedhurinë të paketimit, të mundësojë riciklim të përqindjes së caktuar të peshës së materialeve të cilat janë shfrytëzuar në përpunimin e produktit, i cili është i dedikuar për shitje, në pajtim me standardet në fuqi. Përcaktimi i kësaj përqindjeje mund të ndryshojë, varësisht nga lloji i materialit nga i cili përbëhet paketimi,
- paketimi i cili mund të përpunohet nëpërmjet operacioneve të përpunimit energjetik, kur do të shndërrohet si hedhurinë e paketimit, të ketë vlerë minimale të kalorisë që të mundësohet prodhim optimal i energjisë,
- paketimi i cili mund të përpunohet nëpërmjet operacioneve të kompostimit, doemos duhet të përpunohet në atë mënyrë, që kur do të shndërrohet në hedhurinë të paketimit, të ketë cilësi biologjike zbërthyese që nuk do ta pengojë grumbullimin e veçantë dhe procesin e kompostimit ose aktivitetin në të cilin ajo futet dhe
- paketimi i cili është prodhuar nëpërmjet materieve biologjike zbërthyese, doemos duhet të jetë i përpunuar në atë mënyrë që kur do të shndërrohet në hedhurinë të paketimit, të jetë i asaj natyre që të mund t'i ekspozohet zbërthimit fizik, kimik, termik ose biologjik, kështu që pjesa më e madhe e kompostimit përfundimtar, në fund do të zbërthehet në dyoksid karboni, biomasë dhe ujë.

## Neni 14

### Identifikimi dhe shënimi i paketimit

(1) Paketimi identifikohet dhe shënohet në pajtim me natyrën e materialit nga i cili është prodhuar paketimi, me qëllim që të lehtësohet grumbullimi, ripërdorimi dhe përpunimi, duke e përfshirë edhe riciklimin e paketimit.

(2) Paketimi duhet të identifikohet dhe shënohet me shenjë adekuate në vetë paketimin ose në etiketën e tij, ndërsa nëse madhësia e paketimit atë nuk e lejon, atëherë shënimi duhet të jepet në udhëzimin e bashkëngjitur.

(3) Shënimi duhet t'i përbajë të dhënat si vijojnë:

- 1) llojin e materialit të përdorur në paketim,
- 2) mundësinë e ripërdorimit nëse ekzisto; dhe
- 3) mundësinë e përpunimit, përkatësisht të riciklimit nëse ekziston.

(4) Shenja duhet të jetë qartë e dukshme dhe lehtë e lexueshme, gjatë shitjes dhe gjatë kthimit të paketimit, e qëndrueshme dhe e përhershme, madje edhe kur paketimi është i hapur.

(5) Ministri i Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, në pajtim me ministrin e Ekonomisë, do t'i përcaktojë mënyrën e vënies së numrave dhe shkurtesave në të cilat bazohet sistemi i identifikimit dhe shënimit të materialeve nga të cilat është prodhuar paketimi, si dhe formën dhe

përmbajtjen e shënimit për veprim me paketimin.

## Neni 15

### Informata për shfrytëzuesit e paketimit

(1) Prodhuesit janë të obliguar që në mënyrë adekuate t'i informojnë shitësin dhe konsumatorin për cilësitë e rëndësishme të produktit dhe paketimit të tij, në pikëpamje të materieve dhe substancave të rezikshme dhe të dëmshme, të cilat i përbajnë ato dhe për mënyrën e veprimit me produktet e shfrytëzuara dhe me paketimin kur ai do të bëhet hedhurinë e paketimit.

(2) Prodhuesit janë të obliguar që për çdo lloj materiali nga i cili është prodhuar paketimi të cilat i lëshojnë në treg, të posedojnë të dhëna për sasinë e metaleve të rënda nga neni 11 i këtij ligji.

(3) Prodhuesit janë të obliguar që në çdo lloj paketimi në të cilin është paketuar ose mbushur malli, vet ose nëpërmjet prodhuesve të paketimit t'i sigurojnë të dhënat për sasinë e metaleve të rënda nga neni 11 i këtij ligji.

(4) Prodhuesit e paketimit, janë të obliguar që për çdo lloj materiali që është dedikuar për prodhimin e paketimit, të sigurojnë të dhëna për sasinë e metaleve të rënda nga neni 11 i këtij ligji.

## III. VEPRIMI ME HEDHURINAT E PAKETIMIT

### Neni 16

#### Ndalime

(1) Hedhurina e paketimit, e cila është hedhurinë komerciale dhe/ose nuk është hedhurinë komunale, është e ndaluar që të lihet ose të dorëzohet në vende të shënuara për grumbullim dhe përzgjedhje të hedhurinave komunale nga amvisëritë.

(2) Shfrytëzuesi i fundit, hedhurinën e paketimit, e cila është hedhurinë komerciale dhe/ose nuk është hedhurinë komunale, të cilën e dorëzon ose e kthen në pajtim me këtë ligj, është i obliguar që ta ruajë ndaras, me qëllim që të mos ekzistojë mundësi që të pérzihet me lloj tjetër të hedhurinës dhe të mund të grumbullohet dhe të ripërdoret, përpunohet ose të mënjanohet në pajtim me këtë ose me ligj tjetër.

(3) Shfrytëzuesi i fundit është i obliguar që të sigurojë që hedhurina e paketimit e cila është hedhurinë komerciale dhe/ose nuk është hedhurinë komunale, e të cilën e dorëzon ose e kthen, të mos jetë e ndotur me lëndë të dëmshme ose të rezikshme dhe materiale tjera të cilat nuk janë paketime, nëse këto materiale do ta pamundësonin ripërdorimin ose ripërpunimin e tij, ose kjo do të ishte e mundur vetëm me ndërmarrjen e masave plotësuese të cilat kanë pasur harxhime joproportionalisht të larta.

(4) Shfrytëzuesi i fundit është i obliguar që për hedhurinën nga paketimi e cila është e ndotur me materie të rezikshme ose materie tjera të cilat nuk janë paketim, si posedues i hedhurinës të sigurojë veprim me të njëjtën, në pajtim me dispozitat për veprim me hedhurina.

### Neni 17

#### Obligimet e prodhuesit

(1) Prodhuesi është i obliguar që me harxhime të veta ta sigurojë plotësimin e qëllimeve nacionale nga neni 35 i këtij ligji, nëpërmjet grumbullimit dhe përpunimit ose riciklimit të hedhurinave, që janë krijuar nga paketimi të cilin për herë të parë e ka lëshuar në tregun e Republikës

së Maqedonisë, me:

- marrjen e rregullt të hedhurinës së paketimit që është hedhurinë komunale, në pajtim me nenin 26 paragrafi (3) i këtij ligji dhe ta sigurojnë ripërdorimin, ripërpunimin ose mënjanimin e tij dhe
- marrjen dhe grumbullimin e hedhurinës së paketimit nga konsumuesit e fundit dhe ripërdorimin, përpunimin dhe mënjanimin e tij.

(2) Prodhuesi i cili në të njëjtën kohë është edhe shfrytëzuesi i fundit, është i obliguar që me harxhime të veta ta sigurojë plotësimin e qëllimeve nationale nga neni 35 i këtij ligji, nëpërmjet grumbullimit dhe përpunimit ose riciklimit të hedhurinës që është krijuar nga paketimi, të cilin e ka importuar në tregun e Republikës së Maqedonisë.

(3) Obligimet nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk vlejnë për paketimin që eksportohet si paketim ose si mall i paketuar.

(4) Obligimi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nuk ka të bëjë me subjektet nga nenet 30 paragrafi (3), 31, 32, dhe 33 të këtij ligji.

## Neni 18

### **Veprimi me paketimin shitës, grupor dhe transportues**

(1) Prodhuesi i paketimit, prodhuesi dhe tregtari është i obliguar që hedhurinën nga paketimi grupor dhe transportues, drejtpërdrejt pas dorëzimit të mallit ose gjatë dorëzimit të ardhshëm, ta pranojë prapa pa pagesë nëse shfrytëzuesi i fundit dëshiron ta kthejë. Nëse shfrytëzuesi i fundit e merr mallin vet nga prodhuesi i paketimit, nga prodhuesi ose nga tregtari, hedhurinën e paketimit grupor dhe transportues mund ta lë drejtpërdrejt në vendin e marrjes, ose ta kthejë pa pagesë në mënyrë plotësuese.

(2) Obligimet nga paragafi (1) i këtij neni, zbatohen edhe për paketimin shitës i cili njëkohësisht e kryen funksionin e paketimit grupor ose transportues.

(3) Prodhuesi i paketimit, prodhuesi dhe tregtari, janë të obliguar që falas ta pranojnë prapa edhe hedhurinën e paketimit shitës që është hedhurinë komerciale dhe/ose nuk është hedhurinë komunale, kur shfrytëzuesi i fundit dëshiron ta kthejë dhe për hedhurinën e atillë nuk janë përcaktuar mënyra të veçanta të veprimit.

(4) Për zbatimin e obligimeve nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, prodhuesi i paketimit, prodhuesi dhe tregtari është i obliguar që të rregullojë hapësirë të caktuar dhe të sigurojë pajisje për grumbullimin përzgjedhës të hedhurinës së paketimit, nëse ka hapësirë shitëse më të madhe se 200 m<sup>2</sup>.

(5) Prodhuesi i paketimit, prodhuesi dhe tregtari, sasitë e grumbulluara të hedhurinës së paketimit mund t'i magazinojë përkohësisht ndaras, në hapësirën e vet të mbyllur ose të hapur.

(6) Prodhuesi i paketimit, prodhuesi dhe tregtari që ka hapësirë më të vogël shitëse se 200 m<sup>2</sup>, mund të rregullojë hapësirë dhe të sigurojë pajisje për grumbullimin përzgjedhës të hedhurinës së paketimit.

## Neni 19

### **Lirimi - prodhuesi i vogël**

(1) Obligimi nga neni 17 i këtij ligji, ka të bëjë vetëm me atë prodhues, i cili në vit ka lëshuar në treg ose ka importuar në Republikën e Maqedonisë më tepër se sasitë dhe lloje të veçanta të paketimit, si vijojnë:

- 800 kg qelq,
- 100 kg plastikë,
- 300 kg letër, karton dhe paketim shumështresor të përbërë kryesisht

nga komponentë të letrës dhe kartonit,  
 - 100 kg metal,  
 - 100 kg dru dhe  
 - 100 kg lloje tjera të paketimit.

(2) Sasitë nga paragrafi (1) i këtij neni, llogariten si sasi përbledhëse të veçanta për material të paketimit.

(3) Prodhuesi nga paragrafi (1) i këtij neni, është i obliguar të mbajë evidencë në pajtim me nenin 28 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji.

## **Neni 20**

### **Veprimi kolektiv me hedhurinat e paketimit**

(1) Prodhuesit, zbatimin e obligimeve nga neni 17 i këtij ligji, mund t'i realizojnë në mënyrë të pavarur ose me lidhjen e marrëveshjes së veçantë për ndërmarrjen e obligimeve për veprim me hedhurinën e paketimit me person juridik, i cili në pajtim me këtë ligj dhe/ose me Ligjin për menaxhim me hedhurina, e siguron veprimin me hedhurina të paketimit në emër të tyre dhe për llogari të tyre (në tekstin e mëtejmë: personi juridik për veprim me hedhurinën e paketimit).

(2) Personi juridik për veprimin me hedhurinën e paketimit është i obliguar të sigurojë:

- marrjen e rregullt të hedhurinës së paketimit që është hedhurinë komunale, në pajtim me nenin 26 paragrafi (3) i këtij ligji;
- marrjen dhe rregullimin e rregullt të hedhurinës së paketimit nga shfrytëzuesit e fundit dhe
- ripërdorimin, përpunimin ose mënjanimin e sasisë së ndërmarrë dhe të grumbulluar të hedhurinës së paketimit, në pajtim me alinetë 1 dhe 2 të këtij paragrafi.

(3) Personi juridik për veprim me hedhurinën e paketimit, është i obliguar që të sigurojë leje në pajtim me nenin 21 të këtij ligji.

(4) Kryerjen e punëve nga paragrafi (2) i këtij neni, personi juridik për veprim me hedhurinën e paketimit nuk mund t'i kryejë në mënyrë të pavarur dhe është i obliguar që t'ia ngarkojë personave, të cilët janë të regjistruar për kryerjen e këtyre punëve dhe posedojnë leje adekuate, në pajtim me këtë ligj dhe/ose me Ligjin për menaxhim me hedhurina.

(5) Prodhuesi nga paragrafi (1) i këtij neni, është i obliguar që personit juridik për veprim me hedhurinën e paketimit me të cilin ka lidhur marrëveshje përmarrjen e obligimeve për veprim me hedhurinën e paketimit, t'ia paguajë gmimin adekuat përmarrjen, lidhur me zbatimin e obligimeve për veprim me hedhurinën e paketimit që e krijon prodhuesi.

## **Neni 21**

### **Personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit**

(1) Personi juridik për veprim me hedhurina të paketimit mund t'i veproje me hedhurinat e paketimit në emër dhe në llogari të prodhuesve, nëse ka siguruar marrëveshje përmarrjen e obligimeve për veprim me hedhurina të paketimit me prodhues të cilët së bashku lëshojnë në treg ose importojnë në Republikën e Maqedonisë së paku 15% por jo më shumë se 51% të paketimit primar, sekondar dhe terciar gjatë një viti dhe të posedojnë leje nga paragrafi (2) i këtij neni.

(2) Personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit është i obliguar që të sigurojë leje përmarrjen e obligimeve për veprim me hedhurinën e paketimit nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, në bazë të kërkesës me shkrim e cila veçanërisht i përbën:

- 1) emrin/titullin dhe selinë e personit juridik për veprim me hedhurinat e paketimit;

- 2) periudhën kohore për të cilën kërkohet leja;
- 3) marrëveshjen për themelim ose statutin e personit juridik për veprim me hedhurinat e paketimit;
- 4) listën me emrin, adresën, veprimtarinë, numrin e subjektit afarist dhe numrin tatimor të prodhuesve nga neni 17 i këtij ligji, në emër dhe llogari të të cilat do të veprojë me hedhurinat e paketimit;
- 5) dëshminë se në momentin e parashtrimit të kërkesës, ka lidhur marrëveshje për ndërmarrjen e obligimeve për veprim me hedhurinat e paketimit, me prodhues të cilët së bashku lëshojnë në treg ose importojnë në Republikën e Maqedonisë së paku 5% të paketimit primar, sekondar dhe terciar në nivel vjetor dhe mënyrën në të cilën planifikon që në afat prej një viti nga dita e marrjes së lejes, ta plotësojë kushtin nga paragrafi (1) i këtij neni;
- 6) vërtetimin e personit juridik-gjendjen rrjedhëse nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë;
- 7) shenjën e regjistruar të paketimit, nëse ka për qëllim që me të t'u garantojë pjesëmarrësve në sistem, se do të veprojë me ato hedhurina të paketimit dhe
- 8) programin për veprim me hedhurinat e paketimit nga neni 22 i këtij ligji.

(3) Krahas dokumenteve nga paragrafi (2) i këtij neni, e varësishet nga lloji i paketimit, organi profesional sipas nevojës mund të kërkojë që kerkuesi të dorëzojë edhe të dhëna tjera plotësuese, në pajtim me këtë ligj dhe/ose me Ligjin për menaxhim me hedhurina.

(4) Nëse ndodh ndryshimi i të dhënavës të dorëzuara me lejen nga paragrafi (2) i këtij neni, personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit, është i obliguar që ta njoftojë organin profesional, më së voni në afat prej dy muajsh nga momenti i ndryshimeve të ndodhura.

(5) Personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit, është i obliguar që më së voni deri më 31 mars gjatë dorëzimit të raportit për veprim me hedhurinat e paketimit nga neni 27 i këtij ligji, organit profesional t'ia dorëzojë edhe listën nga paragrafi (2), pika 5 e këtij neni, me çka bëhet regjistrimi në evidencën e prodhuesve në emër dhe llogari të të cilëve, veprohet me hedhurinat e paketimit.

(6) Personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit, është përgjegjës për veprimin e rregullt me hedhurina, në pajtim me këtë ligj dhe për arritjen e qëllimeve nga neni 35 paragrafi (1) i këtij ligji, në emër dhe në llogari të prodhuesve nga neni 17 i këtij ligji, me të cilët ka lidhur marrëveshje për ndërmarrjen e obligimeve për veprimin me hedhurina.

(7) Leja nga paragrafi (2) i këtij neni, jepet për afat prej 5 vitesh.

(8) Lejen nga paragrafi (2) i këtij neni, e jep Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, në bazë të propozimit të organit profesional.

(9) Personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit, prodhuesve nga neni 17 i këtij ligji me të cilët ka lidhur marrëveshje për ndërmarrjen e obligimeve për veprimin me hedhurina, është i obliguar t'u lëshojë vërtetim për lirim nga pagesa e kompensimit nga neni 40 të këtij ligji.

(10) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor e refuzon kërkesën për lëshimin e lejes nga paragrafi (2) i këtij neni, parashtruesi ka të drejtë të parashtrrojë ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë.

(11) Formën dhe përbajtjen e kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, e përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

## Neni 21-a

(1) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera

e mjedisit jetësor nuk lëshon leje për veprim me hedhurina paketimi, përkatësish nuk miraton aktvendim për refuzim të kërkesës për lëshim të lejes nga neni 21 parografi (2) i këtij ligji në afat prej 60 ditësh, parashtuesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditësh pune nga kalimi i këtij afati të paraqesë kërkesë në sekretarinë e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor të miratojë aktvendim me të cilin jepet pëlqim për lëshim të lejes nga neni 22 parografi (2) i këtij ligji. Nëse ministri nuk ka sekretari kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Formën dhe përbajtjen e formularit nga paragrafi (1) i këtij neni i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Më kërkesë nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtues i kërkesës parashton kopje nga neni 21 parografi (2) i këtij ligji për lëshim të lejes.

(4) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, obligohet që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa për lëshim të lejes nga neni 21 parografi (2) i këtij ligji, pranohet ose refuzohet.

(5) Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtuesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

(6) Inspektorati Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje inspektuese në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, nëse është zbatuar procedura në përputhshmëri me ligjin, dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së realizuar ta informojë parashtuesin e kërkesës për gjendjen e konstatuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(7) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer sipas ligjit miraton aktvendim, me të cilin e ngarkon ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor që në afat prej dhjetë ditëve të vendosë për kërkesën e paraqitur, përkatësish ta pranojë ose refuzoje kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtuar.

(8) Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk vendos në afatin nga paragrafi (7) i këtij neni, inspektori do të paraqesë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ, dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor do të vendosë për kërkesën e paraqitur për çfarë në afatin e njëjtë do ta informojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e paraqitur. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtuesin e kërkesës për masat e ndërmarrë.

(9) Nëse ministri nuk vendos edhe në afatin plotësues nga paragrafi (8) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në këtë afat e informon parashtuesin e kërkesës për masat e ndërmarrë.

(10) Nëse inspektori nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni, parashtuesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë të paraqesë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit

Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa paraqitet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(11) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ obligohet që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (10) i këtij neni dhe nëse vërteton se inspektori nuk ka vepruar sipas njofimit të parashtruesit të kérkesës në pajtim me paragrafët (6) dhe (7) të këtij neni dhe/ose nuk paraqet kallëzim në përputhshmëri me paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kérkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin dhe do të caktojë afat plotësues prej pese ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nëse është zbatuar procedura në përputhshmëri me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së realizuar ta informoje parashtruesin e kérkesës për masat e ndërmarrja.

(12) Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi (11) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kérkesës për masat e ndërmarrja.

(13) Në rastin nga paragafi (12) i këtij neni drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ menjëherë, e më së voni në afat prej një ditë pune, do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(14) Në rastin nga paragafi (13) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kérkesës për masat e ndërmarrja.

(15) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në përputhshmëri me paragafin (11) të këtij neni, parashtruesi i kérkesës mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

(16) Nëse ministri nuk vendos në afatin nga paragafi (8) i këtij neni, parashtruesi i kérkesës mund të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(17) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

## Neni 22

### **Programi për veprim me hedhurinat e paketimit**

(1) Programi për veprim me hedhurinat e paketimit, obligativisht i përmban të dhënat si vijojnë:

- Ilojin e paketimit për të cilin personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit, siguron veprim me hedhurinat e paketimit (në tekstin e mëtejmë: sistemi),
- mënyrën e realizimit të qëllimeve nacionale nga neni 35 i këtij ligji,
- mënyrën dhe vëllimin e paraparë të marrjes dhe grumbullimit të hedhurinave të paketimit nga shfrytëzuesit e fundit,
- mënyrën dhe vëllimin e paraparë të marrjes së rregullt të hedhurinave të paketimit, që janë hedhurina komunale të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe nga Qyteti i Shkupit, në pajtim me nenin 26 të këtij ligji dhe me planin për lidhjen e marrëveshjeve të ardhshme me të njëjtat, duke e përfshirë edhe numrin e banorëve që do të jenë të përfshirë në periudhën e vlefshmërisë së programit,
- mënyrën dhe masat e parapara për njofimin e publikut dhe shfrytëzuesve të fundit, në pajtim me nenin 23 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji,
- numrin dhe lokacionet e vendeve dhe qendrave të grumbullimit të cilat

janë përfshirë në sistem dhe titullin e personave juridikë ose fizikë të cilët menaxhojnë me ato;

- llojin dhe kapacitetin e mjeteve dhe të pajisjeve, të cilat i posedojnë personat juridikë ose fizikë, si persona të tjerë sipas nenit 20 paragrafi (4) i këtij ligji, do të përfshihen në sistem, në të cilat do të bëhet grumbullimi, magazinimi i përkohshëm, klasifikimi ose aktivitetet tjera në lidhje me hedhurinat e paketimit, para se të sigurohet ripërdorimi, përpunimi ose mënjanimi i hedhurinave të paketimit,

- sasinë e përgjithshme të paraparë vjetore të hedhurinave të paketimeve të grumbulluara të përgjithshme dhe pjesëmarrjen e llojit të materialeve nga neni 40 paragrafi (2) i këtij ligji, dhe pjesëmarrjen hedhurinave të grumbulluara të paketimit, që dedikohet për ripërdorim, përpunim, riciklim ose eksport,

- mënyrën dhe sasinë e paraparë të hedhurinave të paketimeve të grumbulluara, të cilat janë të dedikuara për ripërdorim, përpunim ose mënjanim me titullin e personave juridikë, të cilët do ta kryejnë ripërdorimin, përpunimin ose mënjanimin;

- dëshmitë se funksionimi i sistemit është i qëndrueshëm financiarisht, planin financiar për zhvillim dhe dëshminë për investimet fillestare në sistem; dhe

- mënyrën e zbatimit të paradhënes, nëse zbatohet.

(2) Gjatë vendosjes së sistemit dhe përgatitjes së programit nga paragafi (1) i këtij neni, personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit, është i obliguar që t'i marrë parasysh çështjet si vijojnë:

- dendësinë e popullsisë dhe sasinë dhe llojin e hedhurinave të paketimit, të cilat janë hedhurina komunale,

- sistemimin e vendeve dhe qendrave grumbulluese, të cilat i ka përfshirë në sistemin për grumbullimin dhe marrjen e hedhurinave të paketimit dhe

- zhvendosjen përkatësisht largësinë hapësinore të objekteve dhe kapaciteteve ku hedhurinat e grumbulluara të paketimeve përpunohen, (riciklohen dhe bëhet përpunimi energjetik i hedhurinave të paketimit) dhe mënjanohen.

(3) Programi nga paragafi (1) i këtij neni, miratohet për periudhën prej pesë vitesh.

(4) Për çështjet nga paragafi (2) i këtij neni, personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit është i obliguar që të sigurojë dëshmi se i ka marrë parasysh dhe në mënyrë adekuate i ka rregulluar të njëjtat.

(5) Grumbullimin, përpunimin dhe mënjanimin e hedhurinave të paketimit, personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit, mund t'ua ngarkojë vetëm personave fizikë dhe juridikë, të cilët posedojnë leje adekuate për veprim me hedhurina në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina, dhe këtë ta kryejnë në mënyrë dhe kushte siç janë përcaktuar me ligj dhe në objekte dhe kapacitet të cilat i plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligj.

(6) Me përjashtim të paragrafit (5) të këtij neni, personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit, mundet bashkim me personat juridikë dhe fizikë nga paragafi (5) i këtij neni, mund të marrë pjesë në aktivitete të trajtimit të hedhurinave të paketimit, të cilat kanë të bëjnë ekskluzivisht me grumbullimin dhe klasifikimin e hedhurinave të paketimit sipas llojit, dengjeve dhe përgatitjes për veprim të mëtejimë me hedhurinat e paketimit, në kushte të përcaktuara me Ligjin për menaxhim me hedhurina.

## Neni 23

### Obligimet për veprim

(1) Personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit, gjatë organizimit të sistemit për veprim me hedhurinat e paketimit, është i obliguar të sigurojë që vendet dhe qendrat e grumbullimit të rregullohen në atë mënyrë që të mundësojnë që shfrytëzuesit e fundit t'i lënë hedhurinat e

paketimit, dhe në rast kur marrja e hedhurinave të paketimit nuk është siguruar drejtpërdrejt te shfrytëzuesit e fundit ose te dorëzuesit e fundit.

(2) Personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit, është i obliguar që në mënyrë adekuate ta informojë opinionin dhe shfrytëzuesit e fundit për dedikimin dhe qëllimet e grumbullimit të hedhurinave të paketimit, për veprim të drejtë me të njëjtat dhe mundësitë për dorëzim dhe kthim falas dhe mundësitë për riciklim dhe përpunim të hedhurinave të paketimit, duke përfshirë edhe informata për ngritjen e përgjegjësisë për veprim të drejtë me hedhurinat e paketimit, dhe për mënyrën në të cilën mund të veprojnë me hedhurinat e paketimit të cilat janë përfshirë në sistem.

(3) Personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit, në bashkëpunim me komunat, Qytetin e Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, është i obliguar që në vende adekuatet ta njoftojë opinionin me adresat e vendeve dhe qendrave për grumbullim, të cilat ekzistojnë në rajonin e asaj komune, Qytetin e Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, të cilat janë përfshirë në sistem, përkatesisht ku kryhet grumbullimi i hedhurinave të paketimit.

## Neni 24

### **Veprimi i pavarur me hedhurinat e paketimit**

(1) Prodhuesit, obligimet nga neni 17 i këtij ligji mund t'i realizojnë në mënyrë të pavarur nëse për këtë kanë siguruar leje për veprim me hedhurinat e paketimit, në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni dhe është regjistruar në evidencën e organit profesional si prodhues, i cili në mënyrë të pavarur siguron veprim me hedhurinat e paketimit të cilat i krijon.

(2) Leja nga paragafi (1) i këtij neni, merret me zbatimin adekuat të dispozitave nga neni 21 dhe neni 22 i këtij ligji.

(3) Në bazë të lejes së marrë, organi profesional lëshon vërtetim se prodhuesi është regjistruar në evidencën e prodhuesve, si subjekt i cili në mënyrë të pavarur siguron veprim me hedhurinat e paketimit të cilat i krijon (në tekstin e mëtejmë: vepruesi i pavarur me hedhurinat e paketimit).

(4) Vepruesi i pavarur i hedhurinave të paketimit, është i obliguar që të sigurojë:

- marrjen e rregullt të hedhurinave të paketimit të cilat ai i krijon;
- marrjen dhe grumbullimin e rregullt të hedhurinave të paketimit nga shfrytëzuesit e fundit dhe
- ripërdorimin, përpunimin ose mënjanimin e sasisë së marrë dhe të grumbulluar të hedhurinave të paketimit, në pajtim me alinetë 1 dhe 2 të këtij parografi.

(5) Vepruesi i pavarur me hedhurina të paketimit, është i obliguar që t'i plotësojë në mënyrë adekuate obligimet nga neni 23 i këtij ligji dhe të dorëzojë raporte në pajtim me ninen 27 të këtij ligji.

(6) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor e refuzon kërkesën për lëshimin e lejes nga paragafi (2) i këtij neni, parashtruesi ka të drejtë të parashtrøjë ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë.

## Neni 24-a

(1) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk lëshon leje për veprim me hedhurina paketimi, përkatesisht nuk miraton aktvendim për refuzim të kërkesës për lëshim të lejes nga neni 24 parografi (2) i këtij ligji në afat prej 60 ditësh, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditësh pune nga

kalimi i këtij afati të paraqesë kërkesë në sekretarinë e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërorë kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor për marrje aktvendimi me të cilin jepet pëlqim për lëshim të lejes nga neni 24 paragrafi (2) i këtij ligji. Nëse ministri nuk ka sekretari kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Formën dhe përbajtjen e formularit nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Më kërkesë nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës parashtron kopje nga neni 24 paragrafi (2) i këtij ligji për lëshim të lejes.

(4) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, obligohet që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, për marrje të aktvendimit me të cilin kërkesa për lëshim të lejes nga neni 24 paragrafi (2) i këtij ligji, pranohet ose refuzohet.

(5) Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

(6) Inspektorati Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, nëse është zbatuar procedura në përputhshmëri me ligjin, dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së realizuar ta informojë parashtruesin e kërkesës për gjendjen e konstatuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(7) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer sipas ligjit miraton aktvendim, me të cilin e obligon ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor që në afat prej dhjetë ditëve të vendosë për kërkesën e paraqitur, përkatësisht ta pranojë ose refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzon kopje të aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(8) Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk vendos në afatin nga paragrafi (7) i këtij neni, inspektori do të paraqesë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ, dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, do të vendosë për kërkesën e paraqitur përfundimisht në afatin e njëjtë do ta informojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje e aktit me të cilin ka vendosur për kërkesën e paraqitur. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrë.

(9) Nëse ministri nuk vendos edhe në afatin plotësues nga paragrafi (8) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në këtë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrë.

(10) Nëse inspektori nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë të paraqesë kundërshtim te sekretaria e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa paraqitet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(11) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ obligohet që në afat

prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit ta shqyrtojë kundërshtimin nga parografi (10) i këtij neni dhe nëse vërteton se inspektori nuk ka vepruar sipas njoftimit të parashtruesit të kërkesës nga paragrafët (6) dhe (7) të këtij neni dhe/ose nuk paraqet kallëzim në përputhshmëri me paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, nëse është zbatuar procedura në përputhshmëri me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së realizuar ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrja.

(12) Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga parografi (11) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrja.

(13) Në rastin nga parografi (12) i këtij neni drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ menjëherë, e më së voni në afat prej një ditë pune, do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(14) Në rastin nga parografi (13) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrja.

(15) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në përputhshmëri me paragrin (11) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

(16) Nëse ministri nuk vendos në afatin nga parografi (8) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(17) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

## Neni 25

### Mbajtja e evidencës

(1) Organi profesional e mban evidencën e personave juridikë të cilët veprojnë me hedhurinat e paketimit, e që kanë marrë leje në pajtim me nenin 21 të këtij ligji, si dhe me prodhuesit nga neni 17 i këtij ligji të cilët kanë lidhur marrëveshje për marrjen e obligimeve për veprim me hedhurina.

(2) Evidencën nga parografi (1) i këtij neni, organi profesional është i obliguar që rregullisht ta azhurnojë dhe ta publikojë në ueb-faqen e vet, dhe së paku një herë në vit ta publikojë në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(3) Organi profesional e mban evidencën e vepruesve të pavarur të hedhurinave të paketimit nga neni 24 i këtij ligji, dhe është i obliguar që ta azhurnojë dhe ta publikojë në ueb-faqen e vet dhe së paku një herë në vit ta publikojë në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(4) Formën dhe përbajtjen e formularit për mbajtjen e evidencës së prodhuesve nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni, mënyrën e mbajtjes së evidencës, si dhe formën dhe përbajtjen e formularit të vërtetimit nga neni 24 paragrafi (3) i këtij ligji, e përcakton ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

## **Neni 26**

### **Obligimet e kryetarit të komunës**

(1) Kryetari i komunës, i komunës në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, është përgjegjës për organizimin e grumbullimit të veçantë të hedhurinave të paketimit, të cilat janë hedhurina komunale të rajonit të komunës, komunës në Qytetin e Shkupit, dhe të Qytetit të Shkupit.

(2) Obligimet nga paragrafi (1) i këtij neni, kryetari i komunës i realizon në bazë marrëveshjes së lidhur me personin juridik për veprim me hedhurinat e paketimit, ose me vepruesin e pavarur të hedhurinave të paketimit.

(3) Me marrëveshjen nga paragrafi (2) i këtij neni, veçanërisht rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të palëve të kontraktuara, kushtet dhe mënyra e vendosjes së veçantë të grumbullimit dhe trajtimit të hedhurinave të paketimit, lloji i hedhurinave të paketimit, kërkosat në lidhje me kualitetin e hedhurinave të grumbulluara, lloji i sistemit të grumbullimit dhe nëse është e mundur edhe të veprimit me hedhurinat e paketimit, mënyra e financimit dhe mbulimit të harxhimeve, mënyra e informimit të opinionit dhe shfrytëzuesve të fundit si dhe çështje tjera me interes të përbashkët.

(4) Në programet për menaxhim me hedhurina dhe aktet e komunave, komunave në Qytetin e Shkupit, dhe të Qytetit të Shkupit me të cilat rregullohet çështja e veprimit me hedhurina komunale dhe lloj tjetër të hedhurinave të parrezikshme, të përcaktuar në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina, obligativisht merren parasysh edhe qëllimet nationale nga neni 35 i këtij ligji.

## **Neni 27**

### **Obligimet për dorëzimin e raporteve**

(1) Personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit dhe vepruesi i pavarur i hedhurinave të paketimit, janë të obliguar që për hedhurinat e paketuara, të cilat i grumbullojnë ose i marrin gjatë një viti kalendarik, të mbajnë evidencë e cila do të dëshmojë se me grumbullimin, ripërdorimin, përpunimin ose mënjanimin së paku deri në fund të vitit të ardhshëm, janë arritur qëllimet nationale të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji.

(2) Personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit është i obliguar që më së voni deri më 31 mars të vitit rrjedhës, organit kompetent t'i dorëzojë raport vjetor për veprim me hedhurinat e paketimit nga ana e prodhuesve, në emër dhe llogari të të cilat është përgjegjës për veprimin e drejtë me hedhurinat e paketimit në pajtim me nenin 21 të këtij ligji, përvitin paraprak i cili veçanërisht përmban të dhëna, për:

1) sasinë dhe llojin e paketimit i cili lëshohet në tregun e Republikës së Maqedonisë;

2) paketimin shitës, grupor dhe transportues:

- sasinë dhe llojin e paketimit që është ripërdorur;

3) për hedhurinat e paketimit që paraqesin hedhurina komunale dhe hedhurina të paketimit të cilat nuk paraqesin hedhurina komunale:

- sasinë dhe llojin e hedhurinave të paketimit, të cilat janë ricikluar ose në mënyrë tjetër janë përpunuar dhe

- sasinë dhe llojin e hedhurinave të paketimit, të cilat janë importuar nga Republika e Maqedonisë për përpunim.

4) pasqyrën e përgjithshme të veprimit me hedhurinat e paketimit.

(3) Vepruesi i pavarur me hedhurinat e paketimit është i obliguar që ta dorëzojë reportin vjetor nga paragrafi (2) i këtij neni, për hedhurinat e paketimit, të cilat ai i krijon.

(4) Njoftimi kryhet në mënyrë të përcaktuar në pajtim me nenin 28 të këtij ligji.

(5) Raporti vjetor nga paragrafi (2) i këtij neni, para dorëzimit organit kompetent obligativisht vërtetohet nga person tjetër i pavarur juridik.

(6) Organi profesional është i obliguar që ta miratojë Raportin vjetor nga paragrafi (2) i këtij neni, në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit.

## Neni 28

### Mbajtja e evidencës së sasive të paketimit

(1) Prodhesi nga neni 17 të këtij ligji, është i obliguar që të mbajë evidencë për llojin dhe sasinë e paketimeve të prodhua, të importuara dhe të eksportuara, në pajtim me llojin e materialit prej të cilit është prodhuar paketimi të cilin e ka lëshuar në treg gjatë një viti kalendarik dhe për veprimin me hedhurinat nga ai paketim, në formë të shkruar dhe elektronike.

(2) Prodhesi është i obliguar që më së voni deri më 31 mars në vitin rrjedhës, organit profesional t'i dorëzojë raport vjetor për llojin dhe sasinë e paketimeve të cilat i kanë lëshuar apo importuar në treg në Republikën e Maqedonisë, në vitin kalendarik paraprak dhe për veprimin me hedhurinat nga ato paketime, në formular për raport vjetor të paketimit dhe hedhurinave të paketimit në formë të shkruar dhe elektronike. Në raportin vjetor bashkëngjitet dhe nënvizohet dëshmia për praninë e metaleve të rënda nga neni 15 paragrafi (3) të këtij ligji.

(3) Prodhesi është i obliguar që për çdo prodhim i cili ka paketim të ndryshëm, të përgatisë specifikim prodhes i cili përban informatë për peshën e paketimit të atij prodhimi, duke përfshirë edhe paketimin e tij grupore dhe transparente.

(4) Prodhesi është i obliguar që në bazë të specifikimit prodhes nga paragrafi (3) të këtij neni, të mbajë evidencë mujore dhe vjetore për paketimin e përgjithshëm të cilin e ka lëshuar në treg apo e ka importuar në Republikën e Maqedonisë, si shfrytëzues i fundit.

(5) Formën dhe përbajtjen e formularit të raportit vjetor nga paragrafi (2) i këtij neni, formën dhe përbajtjen e formularit të specifikimit prodhes nga paragrafi (3) të këtij neni, formën dhe përbajtjen e formularit të evidencës nga paragrafi (4) të këtij neni, si dhe mënyrën në të cilën mbahet evidencia nga paragrafi (4) të këtij neni, i përcakton ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

(6) Nëse prodhesit kanë lidhur marrëveshje me person juridik për veprim me hedhurina të paketimit në pajtim me neni 21 të këtij neni, atëherë raportin vjetor nga paragrafi (2) të këtij neni e parashtron ai person juridik.

(7) Të dhënat nga paragrafi (2) të këtij neni, ruhen pesë vite duke llogaritur nga fundi i vitit kalendarik me të cilin kanë të bëjnë.

(8) Raportin e parë vjetor nga paragrafi (2) i këtij neni, e dorëzojnë prodhesit nëse nuk kanë lidhur marrëveshje me person juridik për veprim me hedhurina të paketimit.

## Neni 29

### Heqja e lejeve

Organi profesional do të fillojë procedurë për heqjen e lejes dhe do ta shlyejë nga evidencia e nenit 25 të këtij ligji, personin juridik për veprim me hedhurinat e paketimit dhe vepruesin e pavarur me hedhurina të paketimit nëse me raportin nga mbikëqyrja e zbatuar konstatohet, se:

- nuk siguron veprim me hedhurinat e paketimit në pajtim me këtë apo ligjtjetër;
- nuk dorëzon raport vjetor, në pajtim me nenin 27 të këtij neni dhe

- nuk i plotëson qëllimet nationale në pajtim me nenin 35 të këtij ligji në vazhdueshmëri në dy vjet apo për dy vjet në një periudhë prej tre vjetësh.

## Neni 30

### Obligime të shfrytëzuesve të fundit dhe dërguesit të fundit

(1) Prodhuesi, i cili njëkohësisht është edhe shfrytëzues i fundi, për kryerjen e veprimit apo aktiviteteve të tij, vetë importon mall të paketuar në paketim dhe për atë nuk ka ndërmjetësues apo shpërndarës paraprak në Republikën e Maqedonisë, është i obliguar që për hedhurinë e paketimit të cilën ai e krijon, të sigurojë veprim me të njëjtin në mënyrën vijuese:

- të lidhë marrëveshje me person juridik për veprim me hedhurina nga neni 21 të këtij ligji, i cili në emër të vet dhe për llogari të vet do të sigurojë ripërdorim, përpunim apo mënjanim të hedhurinës së paketimit apo
- në mënyrë të pavarur të veprojë me hedhurinat e paketimit dhe të sigurojë ripërdorim, përpunim apo mënjanim të tyre, në pajtim me nenin 24 të këtij ligji.

(2) Shfrytëzuesit e fundit, janë të obliguar që hedhurinat të cilat i krijojnë t'i përzgjedhin dhe t'i lënë në vende të caktuara për atë qëllim, apo t'i dorëzojnë te persona juridikë apo fizikë, të cilët posedojnë leje për veprim me hedhurina, në pajtim me procedurat për menaxhim me hedhurina.

(3) Tregtari i cili në të njëjtën kohë është edhe shpërndarës i fundit, është i obliguar që për mallin e paketuar që e shet, të sigurojë:

- deklaratë me shkrim nga personi juridik nga i cili e blen mallin, se ka lidhur marrëveshje me personin juridik i cili vepron me hedhurina të paketimit nga neni 21 të këtij ligji, apo se ai person juridik është veprues i pavarur me hedhurina të paketimit nga neni 24 të këtij ligji,
- në paketim të ketë shenjë, në pajtim me nenin 21 parografi (2) alineja 8 të këtij ligji, apo
- paketimi të dalë në pajtim me nenet 31, 32 dhe 33 parografi (1) të këtij ligji.

## Neni 31

### Paketim me jetëgjatësi

(1) Prodhuesi nuk është i obliguar që të sigurojë veprim me hedhurinat e paketimit, nëse lëshon në treg apo importon paketim i cili ka jetëgjatësi kohore.

(2) Paketimi ka jetëgjatësi, nëse me manipulim me të njëjtin nuk mund të dëmtohet lehtë dhe të ndryshojë vlerën e përdorimit, për të cilën është prodhuar.

(3) Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, i përcakton kushtet nga parografi (2) të këtij neni, si dhe llojet e paketimit të cilat shërbejnë si tregues se paketimi është me jetëgjatësi.

## Neni 32

### Përjashtime nga veprimi

Prodhuesi i vogël nuk është i obliguar që të sigurojë veprim me hedhurinat e paketimit në pajtim me këtë ligj, nëse sasia e materialit të paketimit nga prodhimet të cilat i ka lëshuar në treg apo i importon si shfrytëzues i fundit, nuk i tejkalon sasitë në nivel vjetor, të përcaktuara në nenin 19 parografi (1) të këtij ligji.

## Neni 33

## **Paketime me mbyllës dhe etiketa**

(1) Prodhuesi nuk është i obliguar që të sigurojë veprim me hedhurinat e paketimit i cili krijohet prej mbyllësve apo etiketave, nëse lëshon në treg mbyllës apo etiketa të cilat janë lëshuar në treg së bashku me paketimin, nëse peshë e mbyllësve dhe etiketave së bashku nuk tejkalon 5% nga peshë e paketimit, dhe nuk e tejkalon sasinë për materialin e paketimit nga neni 19 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Nëse mbyllësit dhe etiketat së bashku e tejkalojnë peshën nga paragrafi (1) të këtij nenit, atëherë ato do të llogariten në peshën e përgjithshme të paketimit në pajtim me specifikimin e prodhimit nga neni 28 paragrafi (3) të këtij ligji, dhe në peshën e përgjithshme të paketimit e cila është lëshuar në treg apo importohet në Republikën e Maqedonisë.

(3) Në rastin nga paragrafi (1) të këtij nenit, prodhuesi i paketimit dhe prodhuesi nuk kanë obligim që t'i shënojnë veças mbyllësit dhe etiketat nga paketimi, nëse kjo nuk është e mundshme. Në atë rast shënimini, nëse kjo është e mundshme, vendoset në mënyrë përkatëse në pjesë tjetër të paketimit të atij prodhimi.

### **Neni 34**

#### **Paradhënia**

(1) Për shkak të nxitjes së kthimit dhe të grumbullimit të hedhurinave të paketimit personi juridik për veprim me hedhurina të paketimit apo vepruesi i pavarur me hedhurina të paketimit, mund të vendosin paradhënie të paketimit kthyes, e cila paguhet në vendin e shitjes së mallit të paketuar.

(2) Paradhënia nga paragrafi (1) të këtij nenit, nuk guxon të kalojë shumën prej 30% nga çmimi shitës i mallit të paketuar.

(3) Personi juridik për veprim me hedhurina të paketimit apo vepruesi i pavarur me hedhurina të paketimit, janë të obliguar që ta lajmërojnë organin profesional për vendosjen e paradhënieve, më së voni gjashtë muaj para vendosjes së saj.

(4) Në njoftimin nga paragrafi (3) të këtij nenit, obligativisht përbahen të dhënat në vijim:

- Iloji i paketimit dhe malli i paketuar për të cilin paguhet paradhënia,
- Iartësia e depozitës për paradhënie dhe raporti i saj me çmimin e mallit të paketuar;
- mënyra në të cilën parashihet të arkëtohet paradhënia,
- mënyra e njoftimit të publikut për vendosjen e paradhënieve dhe
- të dhënat tjera të cilat janë të rëndësishme për zbatimin e paradhënieve.

(5) Personi juridik për veprim me hedhurina të paketimit dhe vepruesi i pavarur me hedhurina të paketimit, janë të obliguar që gjatë dorëzimit të raporteve nga nenit 27 të këtij ligji, të dorëzojnë të dhëna të ndara për hedhurinat e grumbulluara nga paketimi kthyes, për të cilin paguhet paradhënia.

(6) Personi juridik për veprim me hedhurina nga paketimi dhe vepruesi i pavarur me hedhurina të paketimit, janë të obliguar që të sigurojnë që shitësi i cili e ka paguar paradhënen të njëjtën ta kthejë, nëse kthehet paketimi kthyes në pajtim me nenin 50 të Ligjit për menaxhim me hedhurina.

## **IV. QËLLIMET NACIONALE PËR GRUMBULLIMIN DHE PËRTRIRJEN, PËRKATËSISHT PËRPUNIMIN E HEDHURINAVE TË PAKETIMIT**

## Neni 35

### **Qëllimet nationale për veprim me hedhurinat e paketimit**

(1) Në territorin e Republikës së Maqedonisë, sasitë vijuese të paketimeve dhe hedhurinat e paketimit duhet të grumbullohen dhe të përpunohen në afatin kohor vijues:

a) deri në fund të vitit 2020, minimum 60% nga pesha e hedhurinave të paketimit, të cilat janë krijuar në territorin e Republikës së Maqedonisë duhet të përpunohet me operacione të përtëritjes apo me operacione të përpunimit energjetik;

b) deri në fund të vitit 2020, minimum 55% e maksimum 80% nga pesha e hedhurinave të paketimit, që është krijuar në territorin e Republikës së Maqedonisë, duhet të riciklohet;

v) deri në fund të vitit 2020, sasitë vijuese të materialit nga të cilat prodhohet paketimi duhet të riciklohen:

- 60% qelq,
- 60% letër dhe karton,
- 50% metale dhe
- 15% drunj dhe

g) deri në fund të vitit 2018, 22,5% plastikë, duke i pasur parasysh vetëm materialet që riciklohen në plastikë.

(2) Sasitë e eksportuara të hedhurinave të paketimit do të llogariten në realizimin e obligimeve dhe plotësimin e qëllimeve të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni, vetëm nëse ekziston dëshmi se të njëjtat janë përpunuar në mënyrë e cila nuk është e dëmshme për mjedisin jetësor dhe është ekuivalent me mënyrën e përcaktuar në dispozitat për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe menaxhim me hedhurinat të Republikës së Maqedonisë.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, përcakton qëllime nationale vjetore për shkak të arritjes graduale të qëllimeve nga paragrafi (1) të këtij neni, të harmonizuara paraprakisht me Komisionin për menaxhim me hedhurina të paketimit, nga neni 38 të këtij ligji.

(4) Qëllimet nga paragrafi (1) të këtij neni, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, mund t'i revidojoë sipas nevojës, e së paku një herë në tre vjet, në pajtim me programin nga neni 36 të këtij neni.

## Neni 36

### **Programi për udhëheqje me hedhurinat e paketimit**

(1) Për arritjen e qëllimeve nationale të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji, me propozimin e organit profesional, ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, miraton program për menaxhim me hedhurinat e paketimit (në tekstin e mëtejshëm: programi).

(2) Programi miratohet për një periudhë prej së paku pesë vjetësh dhe veçanërisht i përbën:

- përshkrimin dhe vlerësimin e situatës ekzistuese me menaxhimin me hedhurinat e paketimit,
- përshkrimin e subjekteve të cilët veprojnë me hedhurinat e paketimit,
- sasinë dhe llojin e hedhurinave të paketimit që krijohet në Republikën e Maqedonisë, si dhe parashikimet e ardhshme dhe trendin e zhvillimit në periudhën e ardhshme pesëvjeçare,
- masat për parandalim nga krijimi i hedhurinave të paketimit dhe masat për nxitjen e grumbullimit, seleksionimit, ripërdorimit, riciklimit dhe formave tjera të përtëritjes, përpunimit dhe mënjanimit të hedhurinave të paketimeve,
- masat për përmirësimin e situatës në tregun për përtëritjen, përpunimin

dhe riciklimin e hedhurinave të paketimit,  
 - masat ekonomike,  
 - masat për edukim dhe zbatimin e fushatës për ngritjen e ndërgjegjes publike për veprim me hedhurinat e paketimit,  
 - pasqyrën e rregullativës ligjore për menaxhim me hedhurina dhe hedhurinat e paketimit dhe masat për përmirësimin e saj,  
 - drejtimet për zhvillimin e ardhshëm për menaxhim me hedhurinat e paketimit,  
 - qëllimet e sasive të paketimit dhe hedhurinave të paketimit të cilat duhet të grumbullohen dhe përpunohen në periudhën e ardhshme dhe  
 - çështje tjera të cilat janë me rëndësi për menaxhim me hedhurinat e paketimit.

(3) Programi përpilohet me pjesëmarrjen e subjekteve të cilat menaxhojnë me hedhurinat e paketimit, komisionit nga neni 38 i këtij ligji dhe organeve të pushtetit shtetëror dhe lokal, organizatave joqeveritare dhe institucioneve tjera publike dhe shkencore.

(4) Në bazë të programit, në mënyrë adekuate do të ndryshohen qëllimet nationale të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji.

## Neni 37

### Marrëveshja vullnetare

(1) Operatorët ekonomikë mund t'i qasen lidhjes së marrëveshjes vullnetare me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, nëpërmjet së cilës do t'i rregullojnë obligimet dhe të drejtat e ndërsjella për arritjen e qëllimeve të njëjtë ose më të mëdha, nga ato të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji dhe arritjen e qëllimeve nga nenin 2 të këtij ligji.

(2) Marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij neni, obligativisht i rregullon çështjet në vijim:

- afatin e skadimit,
- qëllimet dhe afatet për arritjen e tyre,
- mënyrën e përcjelljes së realizimit të qëllimeve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshje,
- obligimet dhe të drejtat e operatorëve ekonomikë dhe të organeve kompetente për pushtetin shtetëror,
- kushtet dhe mënyrën e prishjes së obligimeve dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve.

(3) Marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij neni, shpallet në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(4) Marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe mënyra dhe rezultatet nga zbatimi i saj janë të kapshme për publikun.

## Neni 38

### Komisioni për menaxhim me hedhurinat e paketimit

(1) Për shkak të përcjelljes së situatës me menaxhimin me hedhurina të paketimit në Republikën e Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë formon Komision për menaxhim me hedhurina të paketimit (në tekstin në vijim: Komisioni).

(2) Komisioni përbëhet nga kryetari dhe më së shumti 15 anëtarëve, me mandat prej tre vjetësh dhe përbëhet prej:

- një përfaqësuesi të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor,
- një përfaqësuesi të Drejtorisë për Mjedis Jetësor,
- një përfaqësuesi të Ministrisë së Financave,
- një përfaqësuesi të Ministrisë së Ekonomisë,
- një përfaqësuesi të Shoqatës Ekonomike në Republikën e Maqedonisë,
- një përfaqësuesi të Bashkësisë së Njësive të Vetadministritimit Lokal,

- nga një përfaqësues të çdo personi juridik i cili vepron me hedhurina të paketimit,
- dy përfaqësuesve të vepruesit të pavarur me hedhurina të paketimit,
- një përfaqësuesi të Shoqatës së Konsumatorëve të Maqedonisë,
- dy përfaqësuesve të personave juridikë dhe fizikë të cilët kanë leje për veprim me hedhurina dhe
- një përfaqësuesi të organizatës joqeveritare e cila vepron në fushën e menaxhimit me hedhurina.

(3) Komisioni shqyrton dhe jep mendime të cilat kanë të bëjnë me:

- qëllimet nationale nga neni 35 të këtij ligji,
- programin nga neni 36 të këtij ligji,
- gjendjen me menaxhimin me hedhurina të paketimit,
- zbatimin e këtij ligji,
- propozimin e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e sasisë së hedhurinave të paketimit që krijohet në Republikën e Maqedonisë,
- propozimin e masave për nxitjen e grumbullimit, ripërdorimit, përpunimit dhe mënjanimit të hedhurinave të paketimit,
- propozimin e masave për organizimin dhe mbështetjen e sistemeve dhe mënyrave të menaxhimit me hedhurinat e paketimit dhe
- çështje tjera të cilat janë në lidhje me menaxhimin me hedhurina të paketimit.

(4) Me komisionin kryeson ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

(5) Punët administrative-teknike për nevojat e komisionit i kryen organi kompetent.

(6) Për punën e tij komisioni miraton rregullore.

## Neni 39

### Baza e të dhënavës dhe sistemi informativ

(1) Organi profesional është i obliguar që të vendosë dhe mbajë bazën e të dhënavës për paketimin dhe hedhurinat e paketimit, që lëshohet në treg në Republikën e Maqedonisë.

(2) Baza mbahet në bazë të të dhënavës nga raportet e dorëzuara në pajtim me nenet 27 dhe 28 të këtij ligji dhe vëcanërisht i përmban të dhënat në vijim:

- 1) për sasinë dhe llojin e hedhurinave të paketimit që lëshohet në treg në Republikën e Maqedonisë;
- 2) për paketimin primar, sekondar dhe terciar:
  - sasia dhe lloji i paketimit i cili është ripërdorur;
- 3) për hedhurina të paketimit që paraqet hedhurinë komunale dhe hedhurina të paketimit që nuk paraqet hedhurinë komunale:
  - sasia dhe lloji i hedhurinave të paketimit që është përpunuar dhe mënjanuar dhe
  - sasia dhe lloji i hedhurinave të paketimit që është përfshirë në pjesën e hedhurinave të përpunuara nga pika 2 alineja 1 të këtij paragrafi, e që është ricikluar apo përpunuar në mënyrë tjetër.
- 4) të dhëna për cilësitë e hedhurinave të paketimit (rrezikshmëria dhe ndikimi dëmtues i materialeve nga të cilat është prodhuar paketimi) dhe
- 5) informata për prodhuesit dhe subjektet tjera të cilat kanë obligime për njoftim në pajtim me këtë ligj.

(3) Në bazë të të dhënavës nga paragrafi (2) i këtij neni, organi profesional më së voni deri më 30 maj të vitit rrjedhës, shpall raport për sasitë dhe llojin e paketimit dhe hedhurinave të paketimit që lëshohen në treg në Republikën e Maqedonisë, si dhe menaxhimin me hedhurina të paketimit.

(4) Së bashku me raportin nga paragrafi (3) të këtij ligji, organi profesional shpall të dhëna për realizimin e programit nga neni 36 të këtij ligji, si dhe të dhëna për sistemet ekzistuese për menaxhim me hedhurina

të paketimit.

(5) Të dhënat të mbledhura në bazë të këtij neni përpunohen dhe vleftësohen nga ana e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor – Qendra informative maqedonase për mjedis jetësor në Sistemin informativ për paketim dhe hedhurina të paketimit, e cila është pjesë përbërëse e Sistemi informativ për mjedis jetësor.

(6) Ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e përcakton mënyrën e menaxhimit, formën dhe përmrbajtjen më të afërt të bazës së të dhënavë dhe sistemit informativ për paketim dhe hedhurina të paketimit

## Neni 40

### Instrumentet ekonomike

(1) Prodhesi i cili lëshon në tregun e Republikës së Maqedonisë mallra të paketuara nga të cilat gjatë shfrytëzimit krijohet hedhurina nga paketimi, si dhe prodhesi i cili si shfrytëzues i fundit importon në Republikën e Maqedonisë mallra të paketuara prej të cilave gjatë shfrytëzimit krijohen hedhurina të paketimit, është i obliguar që të paguajë kompensim për menaxhim me hedhurina të paketimit (në tekstin e mëtejshëm: kompensimi).

(2) Kompensim nga paragrafi (1) i këtij neni, është:

Lloji i materialit	Nënloji I materialit	Shuma
1. Qelqi		4.500 den/ton
2. Plastika		20.000 den/ton
3. Letra dhe kartoni		6.200 den/ton
4. Paketim me më shumë shtresa i përbërë kryesisht prej letre apo komponentë kartoni	për pije e längje tjera	22.000 den/ton
	për dedikim tjera	30.000 den/ton
	Kanoçe	8.500 den/ton
5. Metali	Enë të tjera metali	6.200 den/ton
6. Druri		4.000 den/ton

(3) Kompensimi llogaritet në bazë të peshës-neto të paketimit të llogaritur në pajtim me specifikimin prodhes nga neni 28 paragrafi (3) të këtij ligji dhe evidenca nga evidenca mujore, neni 28 paragrafi (4) të këtij ligji.

(4) Obligimi për llogaritjen e kompensimit për prodhesin krijohet në momentin kur për herë të parë në Republikën e Maqedonisë lëshon mallra të paketuara nga të cilat gjatë shfrytëzimit krijohen hedhurina të paketimit.

(5) Obligimi për llogaritjen e kompensimit për prodhesin i cili si shfrytëzues i fundit importon në Republikën e Maqedonisë mallra të paketuar nga të cilat gjatë shfrytëzimit krijohen hedhurina të paketimit, krijohet në momentin kur ka filluar shfrytëzimi i mallit.

(6) Prodhesi dhe prodhesi i cili si shfrytëzues i fundit importon mall të paketuar, është i obliguar që kompensimin nga paragrafi (2) të këtij neni

apo çmimin për shërbimin nga neni 20 paragrafi (5), t'i llogarisë në çmimin e prodhimit të fundit të cilin e lëshon në treg.

(7) Prodhuesi dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit importon mall të paketuar, është i obliguar që të paguajë kompensimin nga paragrafi (2) të këtij neni në llogarinë përkatëse të pagesës, në kuadër të llogarisë së arkës në çdo të 15-ën ditë në muajin rrjedhës, për të gjitha kompensimet e përllogaritura nga muaji i kaluar.

(8) Kompensimi nuk paguhet nëse mallrat e paketuara eksportohen ose shkatërrohen.

(9) Në rastin nga paragrafi (8) të këtij neni, prodhuesi dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit importon mall të paketuar, është i obliguar që të sigurojë deklaratë eksportuese doganore si dëshmi se malli i paketuar, për të cilin nuk është paguar kompensimi nga paragrafi (2) i këtij neni, është eksportuar nga Republika e Maqedonisë respektivisht të sigurojnë procesverbal se malli është shkatërruar.

(10) Në rast të eksportit ose shkatërrimit të mallrave të paketuara për të cilat paguhet kompensim i përcaktuar me këtë nen, si dhe eksportit ose shkatërrimit të qeseve për transportin e mallrave nga neni 40-a të ketij ligji, e për të cilat paraprakisht është paguar kompensim nga paragrafi (2) i këtij neni respektivisht neni 40-a i këtij ligji, prodhuesi dhe prodhuesi që si shfrytëzues përfundimtar importon mall të paketuar, respektivisht personat fizikë ose juridikë kanë të drejtë kthimi të kompensimit të paguar për sasinë e eksportuar, respektivisht të shkatërruar.

(11) Kundër aktvendimit nga paragrafi (10) të këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë që t'i parashtrojë ankesë ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

(12) Mjetet e kompensimit nga paragrafi (2) të këtij neni, janë të hyra të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe paguhen në llogari të veçantë përkatëse pagesore, në kuadrin e llogarisë së arkës.

(13) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në pajtim me ministrin e Financave, i përcakton mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për kthimin e kompensimit në rastet nga paragrafi (10) të këtij neni.

## Neni 40-a

### Lartësia e kompensimeve për qeset për transport të mallrave

(1) Lartësia e kompensimit që paguhet për qese për transportin e mallrave është:

1) - 1 den. /1 kg peshe për qese për transport të mallrave.

(2) Detyrës për pagesën e kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni, është:

1) personi vendas juridik dhe/ose fizik i cili prodhon qese për transport të mallrave të prodhua nga polimeret e etilenit, poli (vinil kloridi) dhe/ose nga masa plastike pa marrë parasysh nëse përbajnjë aditivë përkatës dhe/ose janë bioshpërbërëse dhe

2) personi juridik dhe/ose fizik i cili importon qese për transport të mallrave të prodhua nga polimeret e etilenit, poli (vinil kloridi) ose masa tjera plastike;

(3) Kompensimi nga paragrafi (2) pikat 1 dhe 2 të këtij neni, llogaritet në baze të peshës neto të qeseve për transport të mallrave.

(4) Detyrësit nga paragrafi (2) pika 1 të këtij neni, janë të detyruar që në faturën me të cilat qeset lëshohen për herë të parë në qarkullimin e lirë

juridik dhe në bazë të së cilës arkëtohet kompensimi, ta paraqesin veç e veç peshën neto dhe lartësinë e kompensimit të llogaritur.

(5) Detyrësit nga paragrafi (2) pika 1 të këtij neni, janë të detyruar që ta paguajnë kompensimin në llogari përkatëse pagesore, në kuadër të llogarisë së thesarit në çdo të 15-n ditë të muajit vijues, për të gjitha kompensimet e llogaritura nga muaji paraprak.

(6) Kompensimin për detyrësin nga paragrafi (2) pika 2 të këtij neni, e llogarit dhe arketon organin doganor gjatë arkëtimit të detyrimeve doganore për import dhe e paguan llogari përkatëse pagesore, në kuadër të llogarisë së thesarit.

(7) Kompensimet nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk paguhen nëse qeset eksportohen ose për arsyet tjetër shkatërrohen.

(8) Në rastin nga paragrafi (7) i këtij neni prodhuesi që i ka faturuar qeset, detyrohet që faturës t'ia bashkëngjisë deklaratën eksportuese doganore, si dëshmi se qeset për të cilat nuk është llogaritur kompensim janë eksportuar nga Republika e Maqedonisë, respektivisht të parashtroje procesverbal shkatërrimi i qeseve.

(9) Në rast të eksportit ose shkatërrimit të qeseve për të cilat paraprakisht është paguar kompensim nga paragrafi (1) i këtij neni, detyrësi ka të drejtë kthimi të kompensimit të paguar për sasinë e eksportuar respektivisht të shkatërruar, në pajtim me dispozitat e nenit 40 paragrafi (13) i këtij ligji.

## **Neni 40-b**

### **Obligimi për mënyrën e llogaritjes, pagesës si dhe për mbajtjen e evidencës për kompensimin e llogaritur dhe të paguar**

(1) Prodhesi që lëshon në treg mallra të paketuara dhe prodhesi që si shfrytëzues i fundit importon mallra të paketuara (në tekstin e mëtejmë: obliguesi) detyrohet që kompensimin nga neni 40 paragrafi (2) të këtij ligji, në kohë dhe me rregull ta llogarisë dhe ta paguajë si dhe të mbajë, mirëmbajë dhe ruajë evidencë të saktë dhe të rregullt për kompensimin e llogaritur dhe të paguar.

(2) Në bazë të evidencës nga paragrafi (1) i këtij neni, obliguesi përpilon dhe në çdo tre muaj dorëzon te organi profesional llogaritje për kompensimin e paguar në formular të veçantë.

(3) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerje të punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në pajtim me ministrin e Financave i përcakton mënyrën dhe procedurën për mbajtje, mirëmbajtje dhe ruajtje të evidencës nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe formën dhe përbajtjen e formularit nga paragrafi (2) i këtij neni.

## **Neni 41**

### **Lirimi nga pagimi i kompensimit**

(1) Nga pagimi i kompensimit nga neni 40 paragrafi (2) të këtij neni, lironen:

- 1) prodhesi dhe prodhesi i cili si shfrytëzues i fundit importon mall të paketuar, nëse ka lidhur marrëveshje për marrjen e obligimeve për veprim me hedhurina të paketimit me personin juridik, për veprim me hedhurina të paketimit që ka siguruar leje në pajtim me nenin 21 të këtij ligji;
- 2) prodhesi dhe prodhesi i cili si shfrytëzues i fundit importon mall të paketuar, ka siguruar vërtetim se prodhesi është i regjistruar në evidencën e vepruesit të pavarrur me hedhurina nga neni 24 paragrafi (3) të këtij ligji dhe

3) subjektet të cilat janë përcaktuar me nenet 31 dhe 32 të këtij ligji.

(2) Prodhuesi dhe prodhuesi që si shfrytëzues përfundimtar importon mall të paketuar nga paragrafi (1) pika 1 të këtij neni, lirohen nga pagimi i kompensimit nga neni 40 paragrafi (2) të këtij neni, nëse posedon vërtetim nga neni 21 paragrafi (9) të këtij ligji.

(3) Formularin, formën dhe përbajtjen e vërtetimit nga paragrafi (2) të këtij neni, i përcakton ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (1) të këtij neni, kompensimi nga neni 40 të këtij ligji paguhet në shumë të dyfishtë, nëse:

1) personi juridik për veprim me hedhurina të paketimit apo vepruesi i pavarur me hedhurina, nuk parashtron raport në pajtim me nenin 27 të këtij ligji;

2) organi profesional nuk e miraton reportin në pajtim me nenin 27 paragrafi (6) të këtij ligji, për shkak të mosplotësimit të qëllimeve nationale të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji. Me këtë rast kompensimi paguhet vetëm për dallimin ndërmjet qëllimeve nationale të përcaktuar në pajtim me nenin 35 të këtij ligji dhe qëllimet e arritura në pajtim me reportin vjetor apo konstatimin e personit profesional dhe

3) prodhuesi ka dorëzuar raport jo të saktë vjetor në pajtim me nenin 28 të këtij ligji, në lidhje me llojin dhe sasinë e paketimeve të cilat i ka lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë, apo i ka importuar si shfrytëzues i fundit.

(5) Në rastet nga paragrafi (4) të këtij neni, organi profesional miraton aktvendim.

(6) Kundër aktvendimit nga paragrafi (5) të këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë t'i parashtrojë ankesë ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

(7) Në rastet nga paragrafi (4) të këtij neni, kompensimi i dyfishtë illogaritet sipas lartësisë së kompensimit, të përcaktuar në nenin 40 të këtij ligji, në proporcion me pjesëmarrjen e llojit dhe sasisë së materialit të paketimit që është lëshuar në treg.

## Neni 42

### **Shfrytëzimi i kompensimit dhe programi për financim**

(1) Mjetet e grumbulluara nga kompensimi nga neni 40 paragrafi (1) dhe 40-a paragrafi (1) të këtij neni, shfrytëzohen për nxitjen e aktiviteteve për grumbullimin, transportin, ripërdorimin, përpunimin dhe mënjanimin e hedhurinave të paketimit dhe për mbulimin e pjesshëm të harxhimeve për grumbullim, përtëritje dhe përpunim të hedhurinave nga paketimi shitës, grupor dhe transportues.

(2) Financimi dhe realizimi i aktiviteteve nga paragrafi (1) të këtij neni, kryhet në bazë të programit vjetor për financim, që organi profesional e përgatit në bazë të programit nga neni 36 të këtij ligji.

(3) Programin vjetor për financim e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozimin e ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

(4) Ndarma e mjeteve të programit nga paragrafi (3) të këtij neni, kryhet me konkurs publik të cilin e shpall dhe zbaton organi profesional.

(5) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, mjetet e programit nga paragrafi (3) të këtij neni, mund të ndahen edhe me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, me propozimin e ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, nëse:

- mjetet dedikohen për ndërtimin e objekteve infrastrukturore për grumbullimin, përpunimin dhe mënjanimin e hedhurinave me interes më të gjerë publik;

- dedikimi i mjeteve është përcaktuar në programin nga neni 36 të këtij ligji;
- mjetet dedikohen për plotësimin e obligimeve të cilat janë përcaktuar në marrëveshjet vullnetare nga neni 37 të këtij ligji, dhe
- mjetet dedikohen për mbulimin e pjesshëm të harxhimeve të personave juridikë të cilët e kryejnë përpunimin e hedhurinave të paketimit të llogaritura me çmim të veçantë për një tonelatë hedhurinë të përpunuar nga paketimi.

## Neni 43

### Konkursi publik

(1) Mjetet të cilat ndahen me konkurs publik nga neni 42 paragrafi (4) të këtij neni, dedikohen për financimin dhe realizimin e:

- projekteve për furnizimin e pajisjes për grumbullimin dhe përpunimin e hedhurinave dhe hedhurinave të paketimit,
- projekteve për plotësimin e obligimeve të cilat dalin për operatorët ekonomikë, në pajtim me këtë ligj,
- projekteve për vendosjen e teknologjive të reja për prodhimin e paketimeve, të cilat janë më adekuate për ripërdorim, përpunim dhe riciklim,
- projekteve për edukimin dhe ngritjen e vetëdijes publike të qytetarëve dhe operatorëve ekonomikë për veprim me hedhurina të paketimit,
- projekteve tjera të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në realizimin e qëllimeve nationale nga neni 35 të këtij ligji,
- programeve dhe projekteve tjera për parandalim dhe preventivë në pajtim me nenin 7 të këtij ligji dhe
- projekteve për përmirësimin e situatës në treg për përpunimin dhe riciklimin e hedhurinave të paketimit.

(2) Konkursi publik nga neni 42 paragrafi (4) të këtij ligji, zbatohet nga komision i formuar prej ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni përbëhet prej pesë anëtarëve, nga të cilët:

- një është përfaqësues i organit profesional,
- një është përfaqësues i personit juridik i cili vepron me hedhurina të paketimit që është anëtar i komisionit për menaxhim me hedhurina të paketimit nga nenit 38 i këtij ligji,
- një është përfaqësues i Bashkësisë së Njësive të Vetadiministrimit Lokal në Republikën e Maqedonisë,
- një përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, dhe
- një përfaqësues i personave juridikë të cilit e kryejnë përpunimin e hedhurinave të paketimit.

(4) Konkursi publik nga neni 42 paragrafi (4) i këtij ligji, shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe së paku në dy gazeta ditore të cilat dalin në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

(5) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni, e përcakton propozimin për shpërndarjen e mjeteve në afat prej 30 ditësh nga dita e skadimit të afatit nga paragrafi (4) të këtij neni, dhe ia dorëzon ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

(6) Rezultatet e konkursit shpallen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

### Neni 43-a

(1) Nëse Komisioni nga neni 43 paragrafi (2) i këtij ligji, pas konkursit të shpallur publik dhe afatit të përcaktuar në nenin 43 paragrafi (5) të këtij ligji, nuk përcakton propozim për ndarje të mjeteve, përkatësisht nuk

miraton akt pér moskryerje tē zgjedhjes, pjesëmarrësi i konkursit publik ka tē drejtë që nē afat prej tri ditësh pune tē paraqesë kérkesë te sekretaria e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent pér punët nga sfera e mjedisit jetësor pér marrje vendimi pér ndarje tē mjeteve pas konkursit tē shpallur publik. Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent pér punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk ka sekretari, kérkesa parashtrohet nē sekretarinë e selisë së organit tē administratës shtetërore kompetent pér punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Formën dhe përmbajtjen e formularit nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent pér punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Më kérkesë nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtrues i kérkesës parashtron kopje tē kérkesës pér ndarje tē mjeteve nëpërmjet konkursit publik.

(4) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent pér punët nga sfera e mjedisit jetësor, obligohet që nē afat prej pesë ditëve tē punës nga dita e parashtrimit tē kérkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, pér marrje tē aktvendimit me tē cilin kérkesa pér ndarje tē mjeteve nëpërmjet konkursit publik pranohet ose refuzohet.

(5) Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent pér punët nga sfera e mjedisit jetësor, nuk miraton aktvendim nē afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtruesi i kérkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ nē afat prej pesë ditëve tē punës.

(6) Inspektorati Shtetëror Administrativ obligohet që nē afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit tē njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni tē kryejë mbikëqyrje inspektuese nē organin e administratës shtetërore kompetent pér punët nga sfera e mjedisit jetësor nëse është zbatuar procedura nē përputhshmëri me ligjin dhe nē afat prej tri ditëve tē punës nga dita e mbikëqyrjes së realizuar ta informoje pjesëmarrësin e konkursit publik pér gjendjen e konstatuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(7) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer sipas ligjit miraton aktvendim me tē cilin e ngarkon ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent pér punët nga sfera e mjedisit jetësor që nē afat prej dhjetë ditëve tē vendosë pér kérkesën e paraqitur, përkatësisht ta pranojë ose refuzojë kérkesën dhe ta njoftojë inspektorin pér aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje e aktit me tē cilin ka vendosur pér kérkesën e parashtruar.

(8) Nëse ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent pér punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk vendos nē afatin nga paragrafi (7) i këtij neni, inspektori do tē paraqesë kérkesë pér ngritje tē procedurës kundërvajtëse pér kundërvajtje tē përcaktuar nē Ligjin pér inspeksion administrativ dhe do tē caktojë afat plotësues prej pesë ditëve tē punës nē tē cilin ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent pér punët nga sfera e mjedisit jetësor do tē vendosë pér kérkesën e paraqitur pér çfarë nē afatin e njëjtë do ta informojë inspektorin pér aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje e aktit me tē cilin ka vendosur pér kérkesën e paraqitur. Inspektori nē afat prej tri ditëve tē punës e informon parashtruesin e kérkesës pér masat e ndërmarra.

(9) Nëse ministri nuk vendos edhe nē afatin plotësues nga paragrafi (8) i këtij neni, inspektori nē afat prej tri ditëve tē punës do tē paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe nē këtë afat e informon parashtruesin e kérkesës pér masat e ndërmarra.

(10) Nëse inspektori nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni, parashtruesi i kérkesës nē afat prej pesë ditëve tē punës ka tē drejtë tē paraqesë kundërshtim te sekretaria e drejtorit tē Inspektoratit

Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa paraqitet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(11) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ obligohet që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (10) i këtij neni dhe nëse vërteton se inspektori nuk ka vepruar sipas njoftimit të parashtruesit të kërkesës sipas paragrafëve (6) dhe (7) të këtij neni dhe/ose nuk paraqet kallëzim në përputhshmëri me paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, nëse është zbatuar procedura në përputhshmëri me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së realizuar ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrja.

(12) Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi (11) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrja.

(13) Në rastin nga paragrafi (12) i këtij neni drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë, e më së voni në afat prej një ditë pune, do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(14) Në rastin nga paragrafi (13) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrja.

(15) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në përputhshmëri me paragafin (11) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat tetë ditëve të punës.

(16) Nëse ministri nuk vendos në afatin nga paragrafi (8) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(17) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

## V. MBIKËQYRJA

### Neni 44

(1) Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe të dispozitave të miratuara në bazë të këtij ligji, e kryen Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

(2) Mbikëqyrjen inspektuese të zbatimit të këtij ligji dhe dispozitave të miratuara në bazë të këtij ligji, e kryen Inspektorati Shtetëror për Mjedisin Jetësor.

(3) Mbikëqyrjen e raporteve të parashtruara në pajtim me nenin 27 dhe 28 të këtij ligji, e kryen organi profesional.

(4) Për punët me kompetencë të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit të përcaktuara me këtë ligj, mbikëqyrjen inspektuese për aplikimin dhe zbatimin e këtij ligji e kryejnë inspektorët e autorizuar për mjedis jetësor të komunave, inspektorët e autorizuar për mjedis jetësor të komunave në Qytetin e Shkupit dhe inspektorët e autorizuar për mjedis jetësor të Qytetit të Shkupit.

(5) Mbikëqyrje inspektuese për aplikimin dhe zbatimin e këtij ligji në pjesën e qarkullimit me paketimet, shënimin e paketimeve, informimin e konsumatorëve, e kryen Inspektorati Shtetëror i Tregut.

(6) Mbikëqyrje inspektuese për zbatimin këtij ligji në pjesën e veprimit kundërligjor me hedhurinat e paketimit të cilat nuk janë hedhurina komunale dhe lënien dhe dorëzimin e tyre si mbeturina komunale, e kryejnë inspektorët komunalë të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.

### **Neni 44-a**

#### **Veprimi pas fletëparaqitjes nga personi fizik ose juridik**

(1) Inspektori shtetëror për ambient jetësor, inspektorët e autorizuar për ambient jetësor të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit dhe inspektoret komunale të komunaleve, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit detyrohen që në afat prej shtatë ditësh të veprojnë pas iniciativës ose fletëparaqitjes për ngritjen e procedurës inspektuese.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij nenii inspektori shtetëror i ambient jetësor, inspektorët e autorizuar për ambient jetësor të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit dhe inspektoret komunale të komunaleve, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit janë të obliguar ta njoftojnë bartësin e iniciativës ose fletëparaqitjes për ngritjen e procedurës inspektuese në afat prej shtatë ditësh nga dita e zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese.

### **Neni 44-b**

#### **Të drejta dhe obligime për mënjanimin e parregullsive**

(1) Inspektori shtetëror për ambient jetësor dhe inspektorët e autorizuar për ambient jetësor të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit dhe inspektorët komunale të komunaleve, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit në pajtim me këtë ligj për mënjanimin e parregullsive të përcaktuara, kanë të drejtë dhe detyrë që subjektit të mbikëqyrjes:

- 1) t'ia paraqesin parregullsitë e përcaktuara dhe të caktojnë afat përmënjanimin e tyre;
- 2) t'i urdhërojnë të ndërmarrë masa dhe aktivitete adekuate në afatin që do ta caktojnë;
- 3) përkohësisht t'ia ndalojnë kryerjen e veprimtarisë, profesionit ose detyrës;
- 4) t'i paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje dhe
- 5) t'i paraqesë kallëzim penal ose të ngritë procedurë tjetër përkatëse.

(2) Përmënjanimin e mangësive të përcaktuara inspektori shtetëror për ambient jetësor, inspektorët e autorizuar për ambient jetësor të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit dhe inspektorët komunale të komunaleve, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit mund të kryejnë edhe autorizime dhe përgjegjësi tjera në pajtim me ligjin.

### **Neni 44-v**

#### **Mbikëqyrja e kompensimit të llogaritur dhe të paguar**

(1) Mbikëqyrjen e kompensimit të llogaritur dhe të paguar, lirimt nga pagesa e kompensimit, si dhe për respektimin e afateve për pagesën e kompensimeve, e kryen Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor përmes inspektorëve shtetërorë të mjedisit jetësor.

(2) Për mbikëqyrjen e kryer nga paragrafi (1) i këtij nenii, inspektori

shtetëror i mjedisit jetësor miraton aktvendim.

(3) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë te ministri që udhëheq me organin e administratës shtetëre kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Në rast kur me aktvendim nga paragrafi (2) i këtij neni, që është përfundimtar në procedurë administrative, përcaktohet kthimi i kompensimit të paguar, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor është i obliguar që ta dorëzojë aktvendimin në Ministrinë e Financave për zbatimin e tij.

(5) Në rast kur me aktvendimin nga paragrafi (2) të këtij neni, që është përfundimtar në procedurë administrative, përcaktohet se obliguesi duhet të paguajë kompensim, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor detyrohet që aktvendimin ta dorëzojë te obliguesi.

## **Neni 45**

Inspektorët shtetërorë për mjedisin jetësor, inspektorët e autorizuar për mjedisin jetësor të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkup, inspektorët shtetërorë të tregut, inspektorët komunalë, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese për zbatimin e këtij ligji, mund të kërkojnë bashkëpunim nga përfaqësues të organit të administratës shtetëre, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të brendshme për shkak të sigurimit të mbikëqyrjes inspektuese pa pengesa.

## **Neni 46**

### **Fushëveprimi i inspektorit shtetëror për mjedisin jetësor**

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i vet, inspektori shtetëror për mjedisin jetësor, ka të drejtë:

- 1) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë për realizimin e masave nga neni 7 i këtij ligji, është përgatitur programi për pengimin dhe parandalimin e krijimit të hedhurinave nga paketimi (neni 7 paragrafi (2));
- 2) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë prodhohen paketime të cilat nuk janë në pajtim me standardet e përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji (neni 9 paragrafi (1));
- 3) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë i është dorëzuar raport organit profesional, në rastet e tejkalimit të nivelit të koncentrimit të metaleve të rënda nga neni 11 paragrafi (1) i këtij ligji, në ndonjërin nga 12 kontrollet e njëpasnjëshme mujore të prodhimit standard dhe të rregullt, (neni 11 paragrafi (4));
- 4) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë rezultatet nga matjet e kryera në proceset prodhuese, si dhe metodat e shfrytëzuara matëse ruhen së paku katër vjet dhe vallë janë të kapshme në çdo kohë, për organet inspektuese kompetente me kërkësën e tyre (neni 11 paragrafi (6));
- 5) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë prodhuesi vepron në pajtim me nenin 15 të këtij ligji;
- 6) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë pranohen prapa pa pagesë hedhurinat e paketimeve, drejtpërdrejt pas dorëzimit të mallrave ose gjatë dorëzimit vijues në pajtim me nenin 18 të këtij ligji, nëse shfrytëzuesi i fundit dëshiron ta kthejë;
- 7) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë janë përbushur kushtet për lirim (neni 19);
- 8) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë personi juridik për veprim me hedhurinat nga paketimet, posedon leje për themelimin e sistemit për grumbullimin dhe pranimin kthyes të hedhurinave nga paketimi (neni 21) paragrafi (2));

- 9) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë e ka lajmëruar organin profesional në afatin e përcaktuar, në rast të ndryshimit të të dhënavë të dorëzuar me lejen nga nen 21 paragrafi (2) i këtij ligji (neni 21 paragrafi (4));
- 10) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë organit profesional i janë dorëzuar të dhënat për prodhuesit, paketuesit, tregtarët dhe shfrytëzuesit e fundit me të cilët kanë marrëveshje, janë themelues ose me marrëveshje janë bashkuar në personin juridik për veprim me hedhurinat nga paketimi (neni 21 paragrafi (5));
- 11) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë personi juridik për veprim me hedhurinat nga paketimi, gjatë vendosjes së sistemit dhe përgatitjes së programit nga nen 22 paragrafi (1) i këtij ligji, ka siguruar dëshmi se i ka marrë parasysh të dhënat e obligueshme (neni 22 paragrafi (2));
- 12) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë grumbullimin, përpunimin, mënjanimin e hedhurinave nga paketimi, personi juridik për veprim me hedhurinat nga paketimi ia ka ngarkuar personit juridik ose fizik të cilët posedojnë leje përkatëse (neni 22 paragrafi (5));
- 13) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë vendet e grumbullimit dhe qendrat janë rregulluar në mënyrë që do t'u mundësojë konsumatorëve të fundit t'i lënë hedhurinat nga paketimi, dhe në rastin kur marrja e hedhurinave nga paketimi nuk është siguruar drejtpërdrejt te konsumatorët e fundit ose te dërguesit e fundit (neni 23 paragrafi (1));
- 14) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë informohen publiku dhe konsumatorët e fundit, në pajtim me nenin 23 paragrafi (2) dhe (3) të këtij ligji;
- 15) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë posedohet leje për veprim të pavarur me hedhurinat nga paketimet, dhe vallë është regjistruar në pajtim me nenin 24 të këtij ligji (neni 24 paragrafi (1));
- 16) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë vepruesi i pavarur me hedhurinat nga paketimet, i ka përbushur në mënyrë përkatëse, obligimet nga nen 27 i këtij ligji (neni 24 paragrafi (5));
- 17) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë i është dorëzuar raport për veprimin me hedhurinat nga paketimet për vitin paraprak organit profesional, në afatin e përcaktuar në pajtim me nenin 27 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 18) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë mbahet evidencë për llojin dhe sasinë e paketimit të cilën e ka lëshuar në treg gjatë një viti dhe për veprimin me hedhurinat nga paketimet, me shkrim dhe në formë elektronike, në pajtim me nenin 28 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 19) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë organit profesional në afatin e caktuar, i është dorëzuar raport me shkrim dhe në formë elektronike për llojin dhe sasinë e paketimit të cilën e ka lëshuar në treg dhe për veprimin me hedhurinat nga paketimi, në vitin paraprak (neni 28 paragrafi (2));
- 20) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë prodhuesi për çdo prodhim që ka paketim të ndryshëm, ka përgatitur specifikim prodhues (neni 28 paragrafi(3));
- 21) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë prodhuesi në bazë të specifikimit prodhues nga nen 28 paragrafi (3) të këtij ligji, mban evidencë mujore dhe vjetore për paketimin e përgjithshëm, të cilin e ka lëshuar në treg ose e ka importuar si konsumator i fundit (neni 28 paragrafi (4));
- 22) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë konsumuesi i fundit dhe dorëzuesi i fundit, vepron në pajtim me nenin 30 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji;
- 23) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë janë përbushur kushtet për përashtime në veprim, në pajtim me nenin 32 të këtij ligji;
- 24) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë janë përbushur kushtet nga nen 33 të këtij ligji;
- 25) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë njoftohet organi profesional në afatin e përcaktuar, për vendosjen paradhënes (neni 34 paragrafi (3));
- 26) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë dokumentet dhe të dhënat me të cilat vërtetohet se janë përbushur qëllimet nacionale

nga neni 35 i këtij ligji, janë autentike;

27) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë përmbushen obligimet që dalin nga marrëveshjet vullnetare (neni 37) dhe

28) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë prodhuesi dhe paketuesi të cilët lëshojnë në tregun e Republikës së Maqedonisë paketime dhe paketim të mallrave të paketuara, nga të cilat gjatë shfrytëzimit krijojen hedhurina nga paketimi, vepron në pajtim me ninen 40 të këtij ligji;

(2) Me kërkesën e inspektorit shtetëror për mjedis jetësor, personi i autorizuar i organit kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të brendshme, është i obliguar që të marrë pjesë në kryerjen e punëve nga paragafi (1) i këtij neni.

(3) Me kërkesën e organit profesional në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, mund të marrë pjesë edhe nëpunësi shtetëror i punësuar në organin profesional.

(4) Inspektori shtetëror për mjedis jetësor, është i obliguar që të kryejë mbikëqyrje inspektuese kur këtë e kérkon organi profesional.

## Neni 47

### Miratimi i aktvendimeve të inspektorit shtetëror për mjedisin jetësor

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori për mjedisin jetësor me aktvendim:

1) do t'i obligojë që të përgatisin Program për pengimin dhe parandalim e krijimit të hedhurinave nga paketimi, në pajtim me ninen 7 të këtij ligji (neni 7 paragafi (2));

2) do t'i obligojë që të prodhojnë paketime të cilat janë në pajtim me standarde përcaktuara në neni 9 të këtij ligji (neni 9 paragafi(1));

3) do t'i obligojë që t'i dorëzojnë raport organit profesional, në rastet e tejkalimit të nivelit të koncentrimit të metaleve të rënda nga neni 11 paragafi (1) i këtij ligji, në ndonjërin nga dymbëdhjetë kontrollet mujore të njëpasnjëshme të prodhimit standard dhe të rregullt, (neni 11 paragafi (4));

4) do t'i obligojë që rezultatet nga matjet e kryera në proceset prodhuese, si dhe metodat e shfrytëzuara për matje t'i ruajnë së paku katër vjet, dhe të jenë të kapshme në çdo kohë për organet inspektuese kompetente me kërkesën e tyre (neni 11 paragafi (6));

5) do t'i obligojë që të realizojnë kontolle mujore për përcaktimin e koncentrimit të metaleve të rënda në paketim, dhe rregullisht të dorëzojnë raporte (neni 11);

6) do ta obligojë prodhuesin të veprojë në pajtim me ninen 15 të këtij ligji;

7) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën e prodhuesit, prodhuesit të paketimit dhe tregtarit, nëse grumbullimi dhe përpunimi i hedhurinave nga paketimi që i kanë lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë, nuk është në pajtim me ninen 17 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, si dhe do t'i obligojë që të ndërmarrin masa adekuate (neni 17 paragrafët (1) dhe (2));

8) do t'i obligojë që pa pagesë t'i marrin prapa hedhurinat nga paketimi,

menjëherë pas dorëzimit të mallit ose gjatë dorëzimit vijues në pajtim me

ninen 18 të këtij ligji, nëse shfrytëzuesi i fundit do ta kthejë;

9) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën e prodhuesit të paketimit, prodhuesit dhe tregtarit, nëse nuk i zbatojnë obligimet nga neni 18 paragafi (1), (2) dhe (3) të këtij ligji (neni 18 paragafi (4));

10) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën e prodhuesit, paketuesit dhe tregtarit, nëse nuk janë të përfshirë në sistemin për grumbullim dhe pranim kthyes të hedhurinave nga paketimi (neni 20), ose nuk posedon leje për veprim të pavarur me hedhurinat nga paketimet dhe vërtetim se është i regjistruar (neni 24) prej së paku 30 ditësh, afat në të cilin duhet ta kryejnë atë;

11) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personit juridik, nëse nuk posedon

- leje për veprim me hedhurinat nga paketimi dhe do t'i obligojë që në afat prej 30 ditësh, organit profesional t'i paraqesë kërkesë për marrjen e lejes për veprim me hedhurinat nga paketimi (neni 21 paragrafi (1));
- 12) do ta kufizojë ose ndalojë punën e peronit juridik për veprim me hedhurinat nga paketimi, nëse nuk e ka informuar organin profesional në afatin e caktuar në rast të ndryshimit të dhënavë të dorëzuara me lejen nga neni 21 paragrafi (2) të këtij ligji (neni 21 paragrafi(4));
- 13) do t'i obligojë që organit profesional t'i parashtrojnë të dhëna për prodhuesit me të cilët kanë lidhur marrëveshje për ndërmarrjen e obligimeve për veprim me hedhurinat, (neni 21 paragrafi (5));
- 14) do ta kufizoje ose ndalojë punën e personit juridik për veprim me hedhurinat nga paketimi, nëse gjatë vendosjes së sistemit për veprim me hedhurinat nga paketimet dhe përgatitjes së programit nga neni 22 paragrafi (1) të këtij ligji, nuk ka siguruar prova se i ka marrë parasysh të dhënat e obligueshme në kohëzgjatje prej më së shumti 30 ditë, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar (neni 22 paragrafi (2));
- 15) do ta kufizoje ose ndalojë punën e personit juridik për veprim me hedhurinat nga paketimi, nëse grumbullimin, përpunimin, mënjanimin e hedhurinave nga paketimi, ia ka ngarkuar personit juridik ose fizik të cilët nuk posedojnë leje përkatëse, (neni 22 paragrafi (5)), në kohëzgjatje prej më së shumti 30 ditë, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 16) do t'i obligojë vendet grumbulluese dhe qendrat, që në afat më shumë se 90 ditë, të rregullohen në atë mënyrë që do të mundësojnë që shfrytëzuesit e fundit t'i lënë hedhurinat nga paketimi të cilat nuk janë hedhurina komunale dhe në rast kur ndërmarrja e hedhurinave nga paketimi, nuk është siguruar drejtëpërdrejt te shfrytëzuesit e fundit ose te dorëzuesit e fundit (neni 23 paragrafi (1));
- 17) do t'i obligojë që ta informojnë publikun dhe shfrytëzuesit e fundit, në pajtim me nenin 23 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji;
- 18) do ta kufizoje ose ndalojë punën e vepruesit të pavarur me hedhurinat nga paketimi, nëse nuk posedon leje për veprim të pavarur me hedhurinat nga paketimi dhe nuk është i regjistruar në pajtim me nenin 24 të këtij ligji, dhe do ta obligojë që në afat prej 30 ditësh t'i paraqesë kërkesë organit profesional për marrjen e lejes për veprim të pavarur me hedhurinat nga paketim dhe kërkesë për regjistrim organit profesional (neni 24 paragrafi (1));
- 19) do ta obligojë vepruesin e pavarur me hedhurina nga paketimi, që në mënyrë adekuate t'i plotësojë obligimet nga neni 23 të këtij ligji dhe të dorëzojë raport në pajtim me nenin 27 të këtij ligji (neni 24 paragrafi (5));
- 20) do ta kufizoje dhe/ose ndalojë punën e personit juridik për veprim me hedhurinat nga paketimi ose të vepruesit të pavarur me hedhurina nga paketimi, nëse nuk dorëzon raport në pajtim me nenin 27 dhe 28 të këtij ligji, prej së paku 30 ditësh, afat në të cilin duhet ta dorëzojnë reportin;
- 21) do t'i obligojë t'i dorëzojnë raport për veprim me hedhurinat e paketimit për vitin paraprak, organit profesional në afat prej më së shumti 30 ditësh, në pajtim me nenin 27 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 22) do t'i obligojë që të mbajnë evidencë për llojin dhe sasinë e paketimit që e ka lëshuar në treg dhe për veprim me hedhurinat nga paketimi gjatë një viti, me shkrim dhe në formë elektronike, në pajtim me nenin 28 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 23) do t'i obligojë që të dorëzojnë raport vjetor me shkrim dhe në formë elektronike, për llojin dhe sasinë e paketimit të cilën e ka lëshuar në treg dhe për veprim me hedhurinat nga paketimi, në vitin paraprak në afatin e caktuar organit profesional, (neni 28 paragrafi (2));
- 24) do t'i obligojë që për çdo prodhim që ka paketim të ndryshëm, të përgatisin specifikim të prodhimit, (neni 28 paragrafi (3));
- 25) do t'i obligojë që në bazë të specifikimit të prodhimit nga neni 28 paragrafi (3) të këtij ligji, të mbajnë evidencë mujore dhe vjetore për paketimin e përgjithshëm të cilin e ka lëshuar në treg ose e ka importuar si shfrytëzues i fundit, (neni 28 paragrafi (4));
- 26) do t'i obligojë shfrytëzuesit e fundit që të veprojnë në pajtim me nenin 30 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji;
- 27) do t'i obligojë ta njoftojnë organin profesional, në afatin e caktuar për

vendosjen e paradhënes, (neni 34 paragrafi (3));

28) do t'i obligojë që të sigurojnë ripërdorim, përpunim ose mënjanim të hedhurinave nga paketimi që grumbullohen, ose merren gjatë një viti kalendarik më së voni deri në fund të vitit vijues, me qëllim që të arrihen qëllimet nationale të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji;

29) do t'i obligojë që t'i plotësojnë obligimet që rezultojnë nga marrëveshjet vullnetare (neni 37) dhe

30) do ta kufizojë ose ndalojë punën e prodhuesit i cili lëshon në tregun e Republikës së Maqedonisë paketime dhe mallra të paketuara, nga të cilat gjatë konsumimit krijohen hedhurina nga paketimi, nëse nuk veprojnë në pajtim me nenin 40 të këtij ligji, në kohëzgjatje më së shumti prej 30 ditësh, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet e gjendjes së krijuar.

(2) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët shtetërorë për mjedisin jetësor, konstatojnë se subjektet të cilat menaxhojnë me paketim dhe hedhurina nga paketimi, nuk u përbahen ligjeve dhe dispozitave të tjera, dispozitave teknike, standardeve, rekomandimeve dhe akteve tjera të përgjithshme, me procesverbal do t'i konstatojnë parregullsitë dhe mangësitë e përcaktuara dhe në aktvendim do ta përcaktojë afatin në të cilin duhet të mënjanohen.

(3) Ankesë kundër aktvendimit të inspektorit shtetëror për ambient jetësor mund të paraqitet në afat prej tete ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënes së Punës në Shkallë të Dytë.

(4) Nëse subjektet e paragrafit (1) të këtij neni, nuk veprojnë në pajtim me aktvendimin e inspektorëve shtetërorë për mjedisin jetësor dhe nuk i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar të përcaktuar me aktvendim, inspektori shtetëror për mjedisin jetësor, do t'i paraqesë kërkësë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje, organit kompetent.

(5) Për kryerjen e punëve nga paragafi (1) i këtij neni, inspektori shtetëror për mjedisin jetësor ka të drejtë të ndërmarrë edhe masa tjera të përcaktuara me Ligjin për mjedisin jetësor dhe Ligjin për menaxhim me hedhurinat.

## Neni 48

### **Fushëveprimi i mbikëqyrjes së inspektorëve të autorizuar për mjedisin jetësor të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit dhe të inspektorëve komunalë të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit**

Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i vet, inspektorët e autorizuar për mjedisin jetësor të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit dëshironin që:

1) të kryejnë shikim dhe të përcaktojnë vallë hedhurinat nga paketimi që nuk janë hedhurina komunale, lihen ose dorëzohen si hedhurina komunale në vendet e shënuara për grumbullimin dhe seleksionimin e hedhurinave komunale (neni 16 paragrafi (1));

2) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojnë vallë shfrytëzuesi i fundit vepron me hedhurinat nga paketimi, në pajtim me dispozitat për veprim me hedhurinat, (neni 16 paragrafët (2), (3) dhe (4));

3) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë për zbatimin e obligimeve nga neni 18 paragrafi (1), (2) dhe (3) të këtij ligji, prodhuesi, prodhuesi i paketimit dëshiron, kanë siguruar hapësirë dhe pajisje për grumbullimin seleksionues të hedhurinave nga paketimi, nëse kanë hapësirë për shitje më të madhe se 200 m<sup>2</sup> (neni 18 paragrafi (4)) dhe

4) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë personi juridik për

veprim me hedhurinat e paketimit, vepron në pajtim me marrëveshjen (neni 26).

## Neni 49

Miratimi i aktvendimeve të inspektorëve të autorizuar për mjedisin jetësor të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit dhe inspektorëve komunalë të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët e autorizuar për mjedisin jetësor të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit dhe inspektorët komunalë të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit me aktvendim:

1) do t'i obligojnë personat fizikë ose juridikë që me hedhurinat nga paketimi të veprohet në pajtim me nenin 16 parografi (1) të këtij ligji;

2) do ta obligojë shfrytëzuesin e fundit, që të veprojnë me hedhurinat e paketimit, në pajtim me dispozitat për veprim me hedhurinat (neni 16 paragrafët (1), (2), (3) dhe (4));

3) do t'i obligojë personat fizikë ose juridikë, që hedhurinat komunale t'i lënë në vendet e dedikuara për atë dhe t'i mënjanojnë pasojat nga kundërvajtja e kryer;

4) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën e prodhuesit, prodhuesit të paketimit dhe të tregtarit, nëse për zbatimin e obligimeve nga neni 18 parografi (1), (2) dhe (3) të këtij ligji, nuk kanë siguruar hapësirë dhe pajisje për grumbullim seleksionues të hedhurinave nga paketimi, nëse kanë hapësirë për shitje më të madhe se 200 m<sup>2</sup>, në kohëzgjatje prej më së shumti 15 ditësh, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar, (neni 18 parografi (4)) dhe

5) do ta obligojë personin juridik për veprim me hedhurinat nga paketimi, që të ndërmarrë masa për plotësimin e obligimeve nga marrëveshja dhe do të përcaktojë afat në kohëzgjatje prej më së shumti 90 ditësh, afat në të cilin duhet t'i mënjanojë mangësitë (neni 26).

(2) Ankesa kundër aktvendimit të inspektorit të autorizuar për ambient jetësor të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit dhe inspektoreve komunale të komunaleve, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit mund të paraqitet në afat prej tete ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(3) Për kryerjen e punëve nga parografi (1) i këtij neni inspektorët e autorizuar për mjedisin jetësor të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit dhe inspektorët komunalë të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, kanë të drejtë të ndërmarrin edhe masa tjera, të përcaktuara me Ligjin për mjedisin jetësor dhe Ligjin për menaxhim me hedhurinat. 2

## Neni 50

### Fushëveprimi i mbikëqyrjes së inspektorit shtetëror të tregut

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i vet, inspektori shtetëror i tregut, ka të drejtë:

1) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse në treg lëshohen qese për transport të mallrave në kundërshtim me nenin 8-a parografi (1) të këtij ligji;

2) të kryejë shikim dhe kontroll dhe të përcaktojë vallë me dërgesën e paketimit ose materialet për prodhim të paketimit të cilat i lëshon në treg, prodhuesi ose prodhuesi i paketimit, posedojnë të dhëna se janë plotësuar kushtet nga neni 11 parografi (1) të këtij ligji (neni 11 parografi (2));

3) të kryeje kontroll dhe të përcaktojë nëse tregtari që njëkohësisht është edhe dërgues i fundit për mallin e paketuar që e shet, vepron në pajtim me nenin 30 paragrin (3) të këtij ligji dhe

- 4) të kryejë shikim dhe të konstatojë vallë paketimi është shënuar në pajtim me nenin 14 të këtij ligji, dhe dispozitën e miratuar në bazë të këtij nenii (neni 14), dhe  
 4) të përcaktojë vallë paradhënia zbatohet në pajtim me nenin 34 të këtij ligji. [3]

(2) Në kryerjen e punëve nga paragrafi (1), inspektorati shtetëror i tregut ka të drejtë në ndërmarrjen e masave tjera të përcaktuara me Ligjin përmjedisin jetësor dhe Ligjin përmenaxhim me hedhurinat.

## Neni 51

### Miratimi i aktvendimeve të inspektorit shtetëror të tregut

- (1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori shtetëror i tregut me aktvendim:
- 1) do t'i detyrojë prodhuesit dhe/ose importuesit që t'i heqin nga tregu qeset përmes transportit të mallrave të prodhua nga polimere të etilenit, poli(vinil kloridi) dhe/ose nga masa tjera plastike (neni 8-a paragrafi (1));
  - 2) do ta kufizojë ose ndalojë punën e prodhuesit ose prodhuesit të paketimit, nëse nuk posedojnë të dhëna se janë plotësuar kërkesat nga nenii 11 paragrafi (1) i këtij ligji përmes dërgesës së paketimit ose materialeve përmes prodhimit të paketimit, të cilat i lëshon në treg (neni 11 paragrafi (2));
  - 3) do ta kufizojë ose ndalojë punën e tregtarit nëse nuk vepron në pajtim me nenin 30 paragrafin (3) të këtij ligji, në kohëzgjatje prej më së shumti 30 ditësh, në të cilin afat duhet t'i mënjanjojë arsyet përmes gjendjen e krijuar dhe
  - 4) do t'i obligojë që paketimi të shënohet me shenjë, në pajtim me nenin 14 të këtij ligji dhe dispozitat e miratuar në bazë të këtij nenii dhe
  - 4) do ta përkufizojë ose ndalojë punën e personit juridik përmes veprimit me hedhurinat nga paketimi dhe të vepruar me hedhurina nga paketimi, nëse është zbatuar paradhënie në kundërshtim me nenin 34 paragrafi (2) të këtij ligji, në kohëzgjatje prej më së shumti 30 ditë, afat në të cilin duhet t'i mënjanjojnë shkaqet përmes gjendjen e krijuar (neni 34 paragrafi (2)); [4]

(2) Ankesa kundër aktvendimit të inspektorit shtetëror mund të paraqitet në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, në Komisioni Shtetëror përmes Vendimmarrje së Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës së Shkallës Dytë.

## Neni 51-a

### Procedura e edukimit

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori shtetëror përmjedis jetësor përcakton se janë kryer parregullsi nga nenet 53 paragrafi (1) pikat 1 dhe 5, 55 paragrafi (1) pikat 1 dhe 5 dhe 57 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji përmes herës së parës, detyrohet që të përpilojë procesverbal ku do ta konfirmojë parregullsinë e kryer me sugjerim përvimin e parregullsisë së konstatuar në afat prej tetë ditësh dhe dhënien njëkohësisht të ftesës përmes edukimit të personit respektivisht kryerësit të kundërvajtjes, ku është përcaktuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori shtetëror konstaton se janë kryer parregullsi nga nenet 57 paragrafi (1) pika 3 dhe 58 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij ligji përmes herës së parës, detyrohet që të përpilojë procesverbal ku do ta konfirmojë parregullsinë e kryer me sugjerim përvimin e parregullsisë së konstatuar në afat prej tetë ditësh dhe dhënien njëkohësisht të ftesës përmes edukimit të personit respektivisht kryerësit të kundërvajtjes, ku është përcaktuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(3) Formën dhe përbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e realizimit të edukimit, e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Edukimin e organizon dhe zbaton Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, respektivisht inspektori i autorizuar për mjedis jetësor i cili ka kryer mbikëqyrje inspektuese, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e realizimit të mbikëqyrjes inspektuese.

(5) Edukimi mund të realizohet për më shumë parregullsi të konstatuara të njëjtë ose të njëlojta për një ose më shumë subjekte.

(6) Nëse në terminin e caktuar personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.

(7) Nëse personi ose subjekti për të cilën realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe të njëjtën e mbaron, do të konsiderohet se është edukuar lidhur me parregullsinë e konstatuar.

(8) Nëse inspektori shtetëror respektivisht inspektori i autorizuar për mjedis jetësor gjatë realizimit të mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se janë evituar parregullsitë e konstatuara nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij nenit, miraton konkluzion me të cilin ndërpritet procedura për mbikëqyrje inspektuese.

(9) Nëse inspektori shtetëror respektivisht inspektori i autorizuar gjatë realizimit të mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se nuk janë evituar parregullsitë e konstatuara nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij nenit, parashton kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në Komisionin për Kundërvajtje.

(10) Inspektori shtetëror i mjedisit jetësor respektivisht inspektori i autorizuar i cili ka kryer mbikëqyrje inspektuese, mban evidencë unike për edukimin e realizuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

## **Neni 51-b**

### **Raporte**

Inspektori shtetëror i mjedisit jetësor respektivisht inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor që e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, detyrohet që të mbajë evidencë për mbikëqyrjet dhe kontrollet e kryera te personat juridikë dhe fizikë, për të cilat përgatit raport tremujor dhe të njëjtin e publikon në ueb faqen e organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor respektivisht në ueb faqen e komunës respektivisht të qytetit të Shkupit.

## **Neni 51-v**

Inspektori shtetëror i tregut, realizimin e edukimit dhe mbajtjen e evidencës së mbikëqyrjes së kryer, i kryen në pajtim me Ligjin për Inspektoratin Shtetëror të Tregut.

## **Neni 52**

### **Zbatimi i dispozitave të ligjeve tjera në mbikëqyrjen inspektuese**

Inspektorët shtetërorë për mjedisin jetësor, inspektorët e autorizuar për mjedisin jetësor të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, inspektorët komunalë të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, mbikëqyrjen inspektuese në

Iëmin e menaxhimit me paketim dhe hedhurina nga paketimi, e realizon në pajtim me dispozitat e këtij ligji, Ligjit për menaxhim me hedhurina, Ligjit për mbikëqyrje inspektuese dhe Ligjit për mjedisit jetësor.

## VI. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE

### Neni 53

#### Sanksionet për kundërvajtje për prodhuesit e paketimit

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet prodhuesit të paketimit për kundërvajtje, nëse:

- 1) për zbatimin e masave nga neni 7 i këtij ligji, nuk përgatisin Program për pengimin dhe preventivën e hedhurinave të krijuara nga paketimi (neni 7 paragrafi (2));
- 2) lëshon në treg qese për transport të mallrave në kundërshtim me nenin 8-a paragrafi (1) të këtij ligji;
- 3) prodhon dhe lëshon në treg paketime të cilat nuk janë në pajtim me standardet e përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji;
- 4) lëshon në treg paketime të cilat i tejkalojnë kufijtë e lejuar për metale të rënda, nga neni 11 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 5) nuk posedon të dhëna se janë përbushur kërkesat e nenit 11 paragrafi (1) të këtij ligji, për dërgesën e paketimit ose materialeve për prodhim të paketimit të cilat i lëshon në treg (neni 11 paragrafi (2));
- 6) nuk u dorëzon raport organeve profesionale në rast të tejkalimit të koncentrimit të metaleve të rënda në paketim (neni 11 paragrafi (4));
- 7) nuk siguron të dhëna për sasinë e metaleve të rënda nga neni 11 të këtij ligji, për çdo lloj paketimi në të cilin është paketuar dhe mbushur malli (neni 15 paragrafét (3) dhe (4));
- 8) me paketimin shitës, grupor dhe transportues, nuk vepron në pajtim me nenin 18 të këtij ligji dhe
- 9) nuk ka siguruar hapësirë të veçantë dhe pajisje për grumbullimin e seleksionuar të hedhurinave nga paketimi (neni 18 paragrafi (4)).

(2) Gjobë në shumë prej 600 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet prodhuesit të paketimit nëse ai është person fizik për veprime nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 900 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës te personi juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes së këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim të kryerjes së veprimtarisë së caktuar nga e cila del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më së shumti 15 ditë.

(5) Personit fizik nga paragrafi (2) dhe personit përgjegjës nga paragrafi (3) i këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e detyrës së caktuar nga e cila del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më së shumti 15 ditë.

### Neni 54

#### Sanksionet për kundërvajtëse për prodhuesit e paketimit

(1) Gjobë në shumë prej 6.000 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet prodhuesit të paketimit për kundërvajtje, nëse:

- 1) nuk e shënojnë paketimin në pajtim me nenin 14 të këtij ligji dhe dispozitën e miratuar në bazë të këtij neni (neni 14).

(2) Gjobë në shumë prej 600 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i

kumtohet prodhuesit të paketimit nëse ai është person fizik, për veprimet nga paragafi (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 900 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës te personi juridik për veprimet nga paragafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes së këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e veprimtarisë së caktuar nga e cila del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më së shumti 15 ditë.

(5) Personit fizik nga paragafi (2) dhe personit përgjegjës nga paragafi (3) të këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim i kryerjes së detyrës së caktuar nga e cila del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më së shumti 15 ditë.

## Neni 55

### Sanksione kundërvajtëse për prodhuesit

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit juridik prodhues, për kundërvajtje, nëse:

1) për zbatimin e masave të nenit 7 të këtij ligji nuk përgatisin Program përpengimin dhe preventivën e krijimit të hedhurinave nga paketimi (neni 7 paragafi (2));

2) lëshon në treg paketime të cilat nuk janë në pajtim me standartet e përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji;

3) lëshon në treg paketime të cilat i kanë tejkaluar kufijtë e lejuar për metale të rënda, nga neni 11 paragraf (1) të këtij ligji;

4) nuk posedon të dhëna se janë përmbushur kërkesat nga neni 11 paragafi (1) të këtij ligji, për dërgesën e paketimit ose materialeve për prodhimin e paketimit të cilat i lëshon në treg (neni 11 paragafi (2));

5) nuk u parashtronjë raporte organeve profesionale, në rast të tejkalimit të koncentrimit të metaleve të rënda në paketim (neni 11 paragafi (5));

6) nuk siguron informim për shitësin dhe konsumatorin për karakteristikat kryesore të produktit dhe paketimit të tij, në pikëpamje të materieve dhe substancave të rrezikshme dhe të dëmshme të cilat i përbajnë, dhe për mënyrën e veprimit me prodhimet e përdorura dhe me paketimin kur ai do të bëhet hedhurinë e paketimit (neni 15 paragafi (1));

7) nuk posedon të dhëna për sasinë e metaleve të rënda nga neni 11 i këtij ligji, për çdo lloj materiali prej të cilës është prodhuar paketimi ose materiali për prodhimin e paketimeve të cilat i lëshon në treg (neni 15 paragafi (2));

8) nuk siguron të dhëna për sasinë e metaleve të rënda nga neni 11 i këtij ligji, për çdo lloj paketimi në të cilin është paketuar ose mbushur malli (neni 15 paragafi (3));

9) me paketimin shitës, grupor dhe transportues, nuk vepron në pajtim me nenin 18 të këtij ligji;

10) nuk ka siguruar hapësirë dhe pajisje të veçantë për grumbullimin seleksionues të hedhurinave nga paketimi (neni 18 paragafi (4));

11) nuk mban evidencë për llojin dhe sasinë e paketimit të cilin e ka lëshuar në treg gjatë një viti, me shkrim dhe në formë elektronike (neni 28 paragafi (1));

12) në afat të caktuar nuk u dërgon rapport vjetor organit profesional, për llojin dhe sasinë e paketimit të cilin e ka lëshuar në treg gjatë vitit paraprak, me shkrim dhe në formë elektronike (neni 28 paragafi (2));

13) në afat të caktuar nuk e ka dërguar raportin e parë, në pajtim me nenin 28 paragafi (8) të këtij ligji;

14) nuk vepron në pajtim me nenin 30, kur paraqitet si prodhues i cili njëkohësisht është edhe shfrytëzues i fundit dhe

15) nuk veprojnë në pajtim me nenin 40 të këtij ligji, nëse lëshojnë në treg ose importojnë në Republikën e Maqedonisë, paketime dhe paketim të mallrave të paketuara prej të cilave gjatë përdorimit krijojen hedhurina nga paketimi.

(2) Gjobë në shumë prej 600 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet prodhuesit nëse ai është person fizik, për veprimet nga paragafi (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 900 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës te personi juridik, për veprimet nga paragafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes së këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim të kryerjes së veprimitarise së caktuar nga e cila del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më së shumti 15 ditësh.

(5) Personit fizik nga paragafi (2) dhe personit përgjegjës nga paragafi (3) të këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e veprimitarise së caktuar nga e cila del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më shumti 15 ditësh.

## Neni 56

### Sanksione kundërvajtëse për prodhuesit

(1) Gjobë në shumë prej 6.000 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit juridik prodhues, për kundërvajtje, nëse:

1) nuk e shënon paketimin në pajtim me nenin 14 të këtij ligji dhe dispozitën e miratuar në bazë të këtij neni (neni 14);

2) nuk përgatit specifikim të prodhimit për çdo produkt që ka paketim të ndryshëm (neni 28 parografi (3));

3) në bazë të specifikimit të prodhimit nga neni 28 parografi (3) të këtij ligji, nuk mban evidencë mujore dhe vjetore për paketimin e përgjithshëm të cilin e ka lëshuar në treg ose e ka importuar si shfrytëzues i fundit (neni 28 parografi (4));

4) mban evidencë me të dhëna të pavërteta për sasitë e paketimit të cilat i ka lëshuar në treg, me qëllim që të konsiderohet si prodhues i vogël (neni 19) dhe

5) nuk siguron veprim me hedhurinat nga paketimi për mbyllës ose etiketa, nëse pesha e mbyllësve dhe etiketave e tejkalon 5% të peshës së paketimit dhe e tejkalojnë sasinë për material të paketimit nga neni 19 parografi (1) të këtij ligji (neni 33 parografi (1));

(2) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet prodhuesit, nëse ai është person fizik për veprimitari nga paragafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 1.500 eurosh me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet personit përgjegjës te personi juridik, për veprimitari nga paragafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes së këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e veprimitarise së caktuar nga e cila del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më shumë 15 ditë.

(5) Personit fizik nga paragafi (2) dhe personit përgjegjës nga paragafi (3) të këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e veprimitarise së caktuar nga e cila del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më së shumti 15 ditë.

## Neni 57

### Sanksione kundërvajtëse për tregtarët

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik tregtar, nëse:

- 1) lëshon në treg qese për transport të mallrave në kundërshtim me nenin 8-a parografi (1) të këtij ligji;
- 2) lëshojnë në qarkullim paketim që nuk është shënuar në pajtim me nenin 14 të këtij ligji dhe dispozitën e miratuar në bazë të këtij neni (neni 14);
- 3) me paketimin shitës, grupor dhe transportues, nuk vepron në pajtim me nenin 18 të këtij ligji dhe
- 4) nuk ka siguruar hapësirë të veçantë dhe pajisje për grumbullimin seleksionues, të hedhurinave të paketimit (neni 18 parografi (4)).

(2) Gjobë në shumë prej 600 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet tregtarit nëse ai është personi fizik për veprimet nga paragafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 700 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës te personi juridik për veprimet nga paragafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes së këtij ligji, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e veprimtarisë së caktuar prej së cilës del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më së shumti 15 ditë.

(5) Personit fizik nga paragafi (2) dhe personit përgjegjës nga paragafi (3) të këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e veprimtarisë së caktuar prej së cilës del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më së shumti 15 ditë.

## Neni 58

### Sanksione kundërvajtëse për shfrytëzuesin dhe dërguesin e fundit

(1) Gjobë në shumë prej 2.000 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik i cili është shfrytëzuesi i fundit i paketimeve, nëse:

- 1) hedhurinat e paketimit që janë hedhurina komerciale dhe/ose nuk janë hedhurina komunale, i lënë ose dorëzojnë si hedhurina komunale në vendet e shënuara për grumbullimin dhe seleksionimin e hedhurinave komunale (neni 16 parografi (1));
- 2) nuk vepron me hedhurinat e paketimit, në pajtim me dispozitat nga neni 16, parografi (2), (3) dhe (4), (neni 16, parrafët (2), (3) dhe (4)) dhe
- 3) nuk vepron sipas nenit 30 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 60 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet shfrytëzuesit të fundit nëse ai është personi fizik, për veprimet nga paragafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 700 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës te personi juridik për veprimet nga paragafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes së këtij ligji, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e veprimtarisë së caktuar prej së cilës del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më së shumti 15 ditë.

(5) Personit fizik nga paragafi (2) dhe personit përgjegjës nga paragafi (3) të këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e veprimtarisë së caktuar prej së cilës del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më së shumti 15 ditë.

## Neni 59

## **Sanksione kundërvajtëse për vepruesin e pavarur me hedhurinat e paketimeve**

(1) Gjobë në shumë prej 6.000 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje vepruesit të pavarur me hedhurinat e paketimeve, nëse:

- 1) nuk e lajmëron organin profesional në afatin e caktuar, për vendosjen e paradhënies (neni 34, paragrafi (3));
- 2) nuk ka ndërmarrë masa që shitësi paradhënien që e ka arkëtuar, të kthehet, nëse kthehet paketimi kthyes (neni 34, paragrafi (6));
- 3) nuk është i regjistruar dhe nuk posedon leje për veprim të pavarur me hedhurinat e paketimit, në pajtim me këtë ligj (neni 24, paragrafi (1));
- 4) nuk siguron veprim, në pajtim me nenin 24, paragrafi (4) të këtij ligji;
- 5) nuk i dorëzon raport vjetor organit profesional për hedhurinat që i ka krijuar vet, në pajtim me nenin 27 paragrafét (3) dhe (4) të këtij ligji dhe
- 6) zbaton paradhënie e cila e tejkalon shumën prej 30% nga çmimi shitës i mallrave të paketuara (neni 34 paragrafi (2)).

(2) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet vepruesit të pavarur me hedhurinat e paketimit, nëse ai është person fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 1.200 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës te personi juridik, për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes së këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e veprimtarisë së caktuar prej së cilës del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më së shumti 15 ditë.

(5) Personit fizik nga paragrafi (2) dhe personit përgjegjës nga paragrafi (3) të këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e veprimtarisë së caktuar prej së cilës del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më së shumti 15 ditë.

## **Neni 60**

### **Sanksione kundërvajtëse për personin juridik për veprim me hedhurinat e paketimit**

(1) Gjobë në shumë prej 9.000 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik për veprimet me hedhurinat e paketimit, nëse:

- 1) kryerjen e punëve nga neni 20, paragrafi 2 i këtij ligji, nuk ua ngarkon personave të tretë të cilët janë regjistruar për kryerjen e këtyre punëve dhe posedojnë leje adekuate, në pajtim me këtë ose me ligj tjetër (neni 20 paragrafi (4));
- 2) nuk posedon leje për themelimin e sistemit për grumbullimin dhe pranimin kthyes të hedhurinave të paketimit (neni 21, paragrafi (2));
- 3) nuk e njofton organin profesional në afatin e caktuar në rast të ndryshimit të të dhënëve të parashtruara me lejen nga neni 21, paragrafi 2 i këtij ligji (neni 21, paragrafi (4));
- 4) organit profesional nuk ia dorëzon të dhënat për prodhuesit, paketuesit, tregtarët dhe shfrytëzuesit e fundit me të cilët kanë marrëveshje, janë themelues ose me marrëveshje janë bashkuar te personi juridik për veprim me hedhurinat e paketimit (neni 21 paragrafi (5));
- 5) grumbullimin, përpunimin, mënjanimin e hedhurinave të paketimit ia ngarkon personit juridik ose fizik, të cilët nuk posedojnë leje adekuate (neni 22 paragrafi (5));
- 6) gjatë organizimit të sistemit, nuk vepron në pajtim me nenin 23 të këtij ligji;
- 7) me hedhurinat e paketimit që i ka grumbulluar gjatë një viti kalendarik, nuk vepron në pajtim me nenin 27 paragrafi (1) i këtij ligji;

- 8) nuk e njofton organin profesional në afatin e caktuar, për zbatimin e paradhënies (neni 34 paragrafi (3));
- 9) nuk ia dorëzon në afatin e caktuar ose ia dorëzon raportin e pakompletuar vjetor për veprimin me hedhurinat e paketimit për vitin paraprak, organit profesional (neni 27 paragrafi (2));
- 10) nuk mban evidencë, në pajtim me nenin 27 të këtij ligji;
- 11) nuk dorëzon raport në pajtim me nenin 28 paragrafin (6) të këtij ligji;
- 12) zbaton paradhënie e cila e tejkalon shumën prej 30%, nga çmimi shitës i mallit të paketuar (neni 34 paragrafi (2)) dhe
- 13) nuk ka ndërmarrë masa që shitësi paradhënien që e ka arkëtuar, të kthehet nëse kthehet paketimi kthyes (neni 34 paragrafi (6)).

(2) Gjobë në shumë prej 1.200 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet vepruesit fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 1.500 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës te personi juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes së këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e veprimtarisë së caktuar prej së cilës del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më së shumti 15 ditë.

(5) Personit fizik nga paragrafi (2) dhe personit përgjegjës nga paragrafi (3) të këtij neni, organi për kundërvajtës mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e veprimtarisë së caktuar prej së cilës del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 3 deri më së shumti 15 ditë.

## Neni 61

### Sanksione kundërvajtëse për personin juridik për veprimet me hedhurinat e paketimit

(1) Gjobë në shumë prej 20.000 deri në 30.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik për veprim me hedhurinat e paketimit, nëse:

- 1) ka dorëzuar raport nga neni 27 i këtij ligji i cili përban të dhëna të pavërteta, me qëllim që të konsiderohet se janë plotësuar qëllimet nationale nga neni 35 i këtij ligji, që t'i ikë pagimit të kompensimit nga neni 40 i këtij ligji dhe
- 2) mban evidencë nga neni 28 i këtij ligji, për të dhënat e pavërteta për sasitë e paketimeve të cilat i ka lëshuar në treg, me qëllim që t'i ikë pagimit të kompensimit nga neni 40 i këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 2.000 eurosh me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës te personi juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Kryerësit të kundërvajtjes së këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e veprimtarisë së caktuar prej së cilës del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 30 deri më së shumti një vit.

(4) Personit fizik nga paragrafi (2) i këtij neni, organi për kundërvajtje mund t'i kumtojë sanksion për kundërvajtje, ndalim për kryerjen e veprimtarisë së caktuar prej së cilës del kryerja e kundërvajtjes, në kohëzgjatje prej së paku 15 deri më së shumti 60 ditë.

## Neni 62

### Procedura për barazim dhe ndërmjetësim

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59 dhe 60 të këtij ligji, organet për mbikëqyrjen inspektuese nga neni 44 i

këtij ligji, janë të obliguar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojë procedurë për barazim, para se të parashtrojnë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje.

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 61 të këtij ligji, organet për mbikëqyrjen inspektuese nga neni 44 i këtij ligji, kryerësit të kundërvajtjes do t'i propozojë procedurë për ndërmjetësim, para se të parashtrojnë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje.

(3) Në rastet në të cilat është arritur pajtim për barazim, gjoba kryerësit mund t'i zvogëlohet më së shumti për gjysmën nga gjoba e maksimale e përcaktuar për kundërvajtjen.

(4) Procedurat për barazim dhe ndërmjetësim udhëhiqen në pajtim me dispozitat nga Ligji për mjedisin jetësor.

## Neni 63

### **Udhëheqja e procedurës për kundërvajtje**

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59 dhe 60 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje udhëheq dhe sanksion për kundërvajtje kumton Komisionin për vendimmarrje për kundërvajtjet në fushën e mjedisit jetësor pranë Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejmë: Komision për kundërvajtje).

(2) Procedura para Komisionit për kundërvajtje, mbahet në pajtim me dispozitat të Ligjit për mjedisin jetësor.

(3) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 61 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje udhëheq dhe sanksion për kundërvajtje kumton gjykata kompetente.

## VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

## Neni 64

### **Afatet për zbatim**

(1) Njoftimin e parë prodhuesit nga neni 17 i këtij ligji për llojin dhe sasitë e paketimit të cilin e ka lëshuar në treg dhe që e ka importuar gjatë vitit në pajtim me nenin 28, paragrafi (2) i këtij ligji, është i obliguar që ta dorëzojë më së voni deri më 31 mars 2011.

(2) Prodhuesi evidencën nga neni 28 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji, do të fillojë ta mbajë nga 1 janari 2011.

(3) Raportin e parë vjetor nga neni 28 paragrafi (2) i këtij ligji, personi juridik për veprimin me hedhurinat e paketimit dhe vepruar i pavarur me hedhurinat, janë të obliguar që ta dorëzojnë më së voni deri më 31 mars 2012.

(4) Përbajtja e metaleve të rënda mund ta tejkalojë nivelin nga 100 miligram për kilogram të peshë së masës së përcaktuar në nenin 11 të këtij ligji, deri më 31 dhjetor 2011.

(5) Raporti i parë për sasitë dhe llojin e paketimit që lëshohet në tregun e Republikës së Maqedonisë dhe për menaxhimin me hedhurinat e paketimit në pajtim me nenin 39 të këtij ligji, do të shpallet më së voni deri më 31 dhjetor 2011.

(6) Obligimet për identifikimin dhe shënimin e paketimit nga neni 14 i këtij ligji, do të zbatohen nga 1 shtator 2012.

(7) Dispozitat nga neni 18 paragrafi (4) i këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2012.

(8) Programi për menaxhim me hedhurinat nga neni 36 i këtij ligji, do të miratohet më së voni deri më 30 tetor 2011.

(9) Prodhuesit në pajtim me obligimet nga neni 17 i këtij ligji, janë të obliguar që të bashkohen nëpërmjet themelimit të, dhe/ose lidhjes së marrëveshjes me person juridik për veprim me hedhurinat e paketimit, ose të regjistrohen në evidencë si veprues të pavarur me hedhurinat e paketimit më së voni deri më 30 qershor 2011.

(10) Programin nga neni 7 paragrafi (2) i këtij ligji, prodhuesi i paketimit dhe prodhuesi janë të obliguar që ta përgatisin më së voni deri më 31 dhjetor 2012.

## **Neni 65**

Komisioni për menaxhim me hedhurinat e paketimit Komisionin për menaxhim me hedhurinat e paketimit nga neni 38 i këtij ligji, Qeveria e Republikës së Maqedonisë do ta formojë më së voni deri më 31 dhjetor 2010.

## **Neni 66**

### **Miratimi i dispozitave më të afërta**

Dispozitat më të afërta për zbatimin e këtij ligji, do të miratohen më së voni deri më 30 qershor 2010.

## **Neni 67**

### **Zbatimi i kompensimeve dhe arritja e qëllimeve nationale**

(1) Kompensimi nga neni 40 i këtij ligji, do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2011.

(2) Për vitin 2011 do të konsiderohet se janë arritur qëllimet nationale nga neni 35 i këtij ligji, nëse mblidhet dhe përpunohet paketimi dhe hedhurinat e paketimit në sasi prej 20% nga pesha që është përcaktuar me nenen 35 paragrafi (1) alinetë a) dhe b) të këtij ligji.

(3) Për vitin 2012 do të konsiderohet se janë arritur qëllimet nationale nga neni 35 i këtij ligji, nëse mblidhen dhe përpunohen paketimi dhe hedhurinat e paketimit në sasi prej 30 % nga pesha që është përcaktuar në nenen 35 paragrafi (1) alinetë a) dhe b) të këtij ligji.

## **Neni 67-a**

(1) Prodhuesit mund të vendosin që të mos e paguajnë kompensimin nga neni 40 i këtij ligji, më së vonin deri më 30 qershor 2011 nëse janë në procedurë të bashkimit nëpërmjet themelimit dhe/ose lidhjes së marrëveshjes me personin juridik për veprim me hedhurina të paketimit ose në procedurën për regjistrimin në evidencë si veprues i pavarur me hedhurina nga paketimi.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, prodhuesit që nuk janë bashkuar nëpërmjet themelimit dhe/ose lidhjes së marrëveshjes me personin juridik për veprim me hedhurina nga paketimi ose nuk janë regjistruar në evidencë si veprues të pavarur me hedhurina nga paketimi më së voni deri më 30 qershor 2011, e me këtë rast nuk kanë kryer pagesë të kompensimeve në pajtim me nenen 40 të këtij ligji, detyrohen që më së voni deri më 31 korrik 2011, ta kryejnë pagesën e kompensimeve të papaguara në periudhën nga 1 janari 2011 deri më 30

qershor 2011.

## Neni 68

### Shfuqizimi

Me ditën e fillimit të zbatimit të nenit 40 të këtij ligji, do të shfuqizohet nenı 185 i Ligjit pér mjedisin jetësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 53/2005, 81/2005, 24/2007, 159/2008 dhe 83/2009).

## Neni 69

### Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në afat prej tetë ditësh nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2010.

#### **DISPOZITA NGA LIGJE TË TJERË**

Ligj pér ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit pér menaxhim me paketimin dhe hedhurinat nga paketimi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/2011):

#### **Neni 15**

Dispozitat më të përafërtë nga nenı 51-a i këtij ligji, do të miratohen në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Ligj pér ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit pér menaxhim me paketimin dhe hedhurinat nga paketimi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/2011):

#### **Neni 6**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit pér mbikëqyrje inspektuese.

Ligj pér plotësimin e Ligjit pér menaxhim me paketimin dhe hedhurinat nga paketimi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2011):

#### **Neni 6**

Aktet nënligjore nga nenet 1, 2, 4 dhe 5 të këtij ligji miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Pas miratimit të akteve nënligjore nga nenet 1, 2, 4 dhe 5 të këtij ligji, të njëjtat menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohen në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent pér punët nga sfera e mjedisit jetësor.

Ligj pér plotësimin e Ligjit pér menaxhim me paketimin dhe hedhurinat nga paketimi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2011):

#### **Neni 7**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", përvèç dispozitave nga nenet 1 dhe 3 të këtij ligji që do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit pér themelim të Komisionit Shtetëror pér Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedurë pér Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me paketimin dhe hedhurinat nga paketimi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/2012):

**Neni 8**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa dispozitat e nenit 8-a të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen pas kalimit të nëntë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me paketimin dhe hedhurinat nga paketimi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 39/2012):

**Neni 10**

Dispozita nga neni 40-b paragrafi (3) e përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji, do miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me paketimin dhe hedhurinat nga paketimi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 163/2013):

**Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 maji 2014.